



South East European Network
for Professionalization of Media

MOBILIZIMI NË MBROJTJE TË INTERESIT PUBLIK NË MEDIA

**Shembuj të metodave dhe
praktikave më të mira të
aktivizmit mediatik**

Sanela Hodžić



South East European Network
for Professionalization of Media

MOBILIZIMI NË MBROJTJE TË INTERESIT PUBLIK NË MEDIA

Shembuj të metodave dhe praktikave më të mira të aktivizimit mediatik

Autore dhe studiuese: Sanela Hodžić

Editore, përgjegjëse e studimit rajonal: Brankica Petković

Përkthyes: Altin Fortuzi

Redaktor: Kristina Lani

Dizajn: Špela Kranjec

Botues:

Fondacioni "Mediacentar", Sarajevë

Instituti i Paqes, Lubjanë

Sarajevë, janar 2024



*Botimi u krye me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian.
Përmbajtja e tij është përgjegjësia e vetme e autorit dhe botuesve
dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pozicionin e Bashkimit Europian.*

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	4
1.1. PËRKUFIZIMI I AKTIVIZMIT MEDIATIK	6
II. NJË PREZANTIM I SHKURTËR I HISTORISË SË GJATË TË AKTIVIZMIT MEDIATIK	8
III. SHEMBUJ TË MIRË TË AKTIVIZMIT MEDIATIK	12
3.1. PLATFORMAT ALTERNATIVE	12
3.1.1. Platformat me përmbajtje alternative dhe shërbime alternative në internet	13
3.1.2. Mediat e komunitetit	15
3.1.3. Organet e pavarura të medias	18
3.1.4. Projektet, qendrat dhe rrjetet rajonale / ndërkombëtare të gazetarisë investigative	19
3.1.5. Mbështetja për iniciativat për media alternative dhe të pavarura	22
3.2. STUDIME, FUSHATA DHE ADVOKIM PËR REFORMA NË MEDIA	24
3.2.1. Koalicionet dhe rrjetet për reforma në media	24
3.2.2. Organizata që kërkojnë reforma mediatike për garantimin e lirisë së shprehjes	26
3.2.3. Aktivizëm dhe reagim kundër iniciativave politike reaksionare duke kërkuar ndryshime progresive të politikave	28
3.2.4. Aktivizmi mediatik me fokus në legjislacion: monitorim, mbështetje ligjore dhe advokim për të ndaluar keqpërdorimin e ligjit	30
3.2.5. Aktivizmi mediatik mbi baza gjinore	33
3.2.6. Advokim për reklama etike dhe eliminimi i të ardhurave për praktika joetike në media	34
3.2.7. Verifikimi i fakteve	36
3.2.8. Aktivizëm për llogaridhënien në media	38
3.2.9. Iniciativa të tjera për monitorimin dhe mbikëqyrjen e mediave	39
3.3. RRITJA E KAPACITETEVE TË MEDIAS, GAZETARËVE DHE QYTETARËVE	40
3.4. ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE PËR LIRINË E MEDIAS DHE ZHVILLIMIN MEDIATIK, RRJETE DHE INICIATIVA DONATORËSH	43
IV. DISKUTIME PËRMBYLLËSE	44
LITERATURA DHE BURIMET	48
MBI AUTORIN	52

I.

HYRJE

Media dhe komunikimi po bëhet gjithnjë e më shumë fronti më i rëndësishëm i betejave politike. Kjo vjen ngaqë sektori i medias dhe komunikimit është i ndikuar dhe ngarkuar me probleme dhe çështje politikisht shumë të rëndësishme, duke filluar që nga ndërhyrjet në politikat editoriale, përqendrimi dhe konvergimi i pronësisë në pak duar, siguria dhe mbikëqyrja e informacionit, cilësia dhe diversiteti i informacionit, si dhe roli themelor që luajnë media dhe platformat e komunikimit në diskursin publik dhe proceset politike. Në ditët tonë mediat nuk janë vetëm kanale për komunikimin dhe pasqyrimin e realitetit shoqëror, por një media demokratike është parakusht i demokracisë.¹ Në regjimet represive në mbarë botën, gazetaria e pavarur është vënë nën presion të madh, madje në disa prej tyre është eliminuar krejtësisht. Sidoqoftë, media është në krizë në mbarë botën, ku mediat janë kapur kryesisht nga interesat e korporatave dhe politika.² Tendencat globale të polarizimit dhe radikalizimit në vazhden e luftërave dhe konflikteve në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme po i përkeqësojnë këto problemet, paralelisht me sfidat që dalin nga ndryshimet teknologjike dhe dominimi i platformave të mëdha teknologjike që kërcënojnë të reduktojnë akoma më tej prodhimin e përmbajtjes mediatike të pavarur, cilësore, dhe informacioneve me interes të përgjithshëm. Për këto arsye, aktivizmi mediatik po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Në këtë raport bazohemi mbi idenë se performanca e medias dhe reformat në media do të përcaktojnë rrjedhën e historisë, dhe se promovimi i praktikave të mira në punën e medias do të ndihmojë në formëzimin e një aktivizmi mediatik për të mundësuar mbizotërimin e vlerave të interesit publik në gazetari, media dhe komunikim në këto momente krize.

Aktivizmi mediatik mund të përshpejtojë realizimin e ndryshimeve pozitive dhe reformave në institucionet mediatike, politikat e medias, përmbajtjen dhe praktikën mediatike, por mund të ndihmojë edhe në krijimin e mediave të reja alternative, si hapësira që ofrojnë përmbajtje me interes publik dhe promovojnë vlera demokratike. Duke pasur parasysh këtë, përmbledhja e disa prej shembujve më të mirë të aktivizmit mediatik në këtë raport synon të frymëzojë ndërhyrje më energjike dhe efikase për të mbrojtur interesin publik në media dhe komunikim. Më konkretisht, një nga synimet është krijimi dhe identifikimi i praktikave më të mira të edukimit mbi median dhe informacionin

Identifikimi i praktikave të mira do të na ndihmojë të planifikojmë aktivizmin mediatik që mundëson përhapjen e vlerave të interesit publik në gazetari, mediat dhe komunikimin në këto kohë krize.

1 Sipas kësaj linje argumentimi, Jakubowicz (1990) e konsideron komunikimin demokratik si "demokraci komunikuese" d.m.th. si një mjet për të arritur vendosjen e demokracisë në një kuptim më të gjerë.

2 Shiko Schiffrin, 2021.

nga koalicionet e organizatave të shoqërisë civile (OSHC), në kuadër të projektit Media Jonë (*Our Media*)³ dhe më gjerë. Aktivizmi mediatik dhe edukimi mbi median dhe informacionin lidhen ngushtë me njëra-tjetrën, pasi vetëm një qytetari e arsimuar mediatikisht mund të mobilizohet me sukses në përpjekjet për të realizuar reforma thelbësore në media dhe komunikim.

Në tabllonë e përgjithshme të situatës përfshihen edhe shembuj të aktivizmit mediatik nga vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia) dhe Turqia, si dhe nga vende të BE-së dhe pjesës tjetër të botës. Identifikimi i praktikave të mira mediatike u krye gjatë periudhës qershor-tetor 2023, dhe puna u bazua kryesisht në kërkime dytësore, dhe aty ku ishte e nevojshme në punë kërkimore parësore, si në analizimin e materialeve nga burime online dhe kërkesa për informacion nga institucione të lidhura me median. Studimi mbështetet në të dhëna nga shtatë studiues nga vende të rajonit: Ilda Londo (Shqipëri), Anida Sokol (Bosnjë dhe Hercegovinë), Florent Spahija (Kosovë), Milica Bogdanoviç (Mali i Zi), Vesna Nikodinoska (Maqedonia e Veriut), Milica Janjatoviç Jovanoviç (Serbi), dhe Sinem Aydinli (Turqi).⁴

Ky raport nis me një analizë të përkufizimeve dhe konceptualizimeve të aktivizmit mediatik, i ndjekur më pas nga një tablo e shkurtër e historisë së aktivizmit mediatik. Pas kësaj paraqiten dhe analizohen shkurtimisht disa shembuj të mirë të aktivizmit mediatik, ndërsa në pjesën përmbyllëse analizohen mundësi zhvillimi dhe sfida që dalin përpara dhe propozohet një tipologji e aktivizmit mediatik.

Së fundi, ky raport synon të paraqesë disa nga shembujt më të mirë të aktivizmit në media, duke përfshirë edhe ndërhyrje të suksesshme që kanë sjellë ndryshime të politikave dhe praktikave në media, por edhe përpjekje të suksesshme që kanë nxitur riformulimin e politikave publike dhe pëmirësimin e nivelit të ndërgjegjësimit publik, zgjerimin e bazës së mbështetjes për reforma, si dhe shembuj aktivizmi mbi tema të reja dhe metodologji të reja, ose përpjekje që konsiderohen të suksesshme pasi kanë sfiduar politikat dhe praktikat ekzistuese.⁵ Nuk po pretendojmë se kemi përzgjedhur të gjithë shembujt më të mirë dhe më të efektshëm të aktivizmit mediatik, por jemi munduar të pasqyrojmë një gamë sa më të gjerë për sa i përket fokusit tematik, llojeve të metodave dhe veprimeve, grupeve të përfshira në aktivizëm, vendndodhjes gjeografike dhe kontekstit politik.

3 Projekti Media Jonë zbatohet nga një koalicion organizatash të aktivizmit mediatik nga vende të Ballkanit Perëndimor dhe Turqia. Mund të shihni më shumë në faqen e internetit të Rrjetit të Evropës Juglindore për Profesionalizimin e Mediave, në <https://seenpm.org/about-the-project/>. Ky raport mbi shembuj të mirë të aktivizmit mediatik është hartuar si pjesë e projektit Media Jonë.

4 Falenderojmë edhe Mirela Rožajac-Zulçiq për ndihmesën në mbledhjen e raporteve dhe të dhënave të tjera mbi praktika të mira të aktivizmit mediatik jashtë rajonit të Evropës juglindore dhe Turqisë.

5 Mbi mënyrën se si aktivizmi mediatik po sfidon konceptin tradicional të "suksesit" në literaturën e lëvizjes sociale, shiko Carroll dhe Hackett (2006, 100) si dhe Hackett (2016).

1.1. PËRKUFIZIMI I AKTIVIZMIT MEDIATIK

Aktivizmi mediatic është analizuar zakonisht në kuadër të studimeve mbi median⁶, dhe nga këndvështrimi i politikëbërjes, por gjatë dekadave të fundit po trajtohet gjithnjë e më shumë nga këndvështrimi i lëvizjeve sociale.⁷

Studiues, teoricienë, dhe aktivistë të medias kanë përdorur terma dhe elemente të ndryshme konceptuale për të përkufizuar aktivizmin mediatic, duke filluar nga “liria e medias” ose “liria e shprehjes” (duke u përqendruar kryesisht tek shkeljet e lirisë nga institucione qeveritare dhe korporata), “reformat në media” (që nënkuptojnë reformimin e strukturave ekzistuese të medias), “media alternative” si një formë aktivizmi mediatic, deri tek “e drejta e komunikimit” (duke e vënë theksin tek lidhja midis komunikimit dhe të drejtave të tjera të njeriut), “demokratizimi i medias” (duke u përqendruar mbi rolin e medias në informimin dhe aftësimin e një qytetarie aktive), “drejtësia mediatiche” (për përfaqësimin e pakicave dhe evitimin e marginalizimit), si dhe konceptin e “mjedisit kulturor” (ku mjedisi kulturor konsiderohet aktualisht si produkt i një mjedisi mediatic problematik, të centralizuar, të globalizuar dhe komercialist).⁸ Ka njëfarë hezitimi midis ekspertëve të fushës për të dalë me një përkufizim të unifikuar (Napoli 2007, 2) ndaj përdoren edhe terma të ndryshme për të përkufizuar aktivizmin në media. Për shembull, Hackett dhe Carroll e përkufizojnë atë që e quajnë demokratizim të medias si: “...aktivizëm nga gjiri i medias për të zgjeruar gamën e zërave që kanë akses në media, për të ndërtuar një sferë publike mbi baza barazie dhe pjesëmarrjeje, për të promovuar vlerat dhe praktikat e një demokracie të qëndrueshme si brenda ashtu dhe jashtë medias, dhe për të ndrequr pasojat e pabarazisë politike dhe ekonomike në sistemin shoqëror.” (2004, –).

Ndonëse një përkufizim i përbashkët mund të jetë i dobishëm kur bëhet fjalë për analizimin e mobilizimit të përbashkët masiv, për hir të akumulimit të njohurive, si në rastin e studimit tonë, do të përdorim një interpretim holistik të aktivizmit mediatic që përfshin të gjitha elementet dhe kornizat e lartpërmendura. Napoli thotë se pavarësisht nga përkufizimet dhe prioritetet, lëvizja për “përmirësimin e sistemit të medias dhe komunikimit (...) mund të studiohet shumë mirë si një fenomen më vete megjithë kompleksitetin e tij” (2007, 9). Ose siç vëren Opel (2004), kornizat dhe përkufizimet e ndryshme “...i referohen një game të gjerë çështjesh dhe organizatash që merren me rolin e medias në botën moderne” (f. 25; shiko edhe Klein, 2001).

Rezultatet e aktivizmit mediatic, pra lufta për të drejtat e komunikimit/demokratizimin e mediave/drejtësi mediatiche/reformat mediatiche, do të përcaktojnë, sikurse tashmë po bëjnë, rrjedhën e historisë.

6 Po aty, 531-532.

7 Paralelisht me këtë, studiuesit dhe teoricienët e lëvizjeve sociale nuk janë përqendruar edhe aq mbi rolin e medias dhe teknologjisë së informacionit si objekt aktivizmi, por si platforma që mundësojnë aktivizmin mbi çështje që nuk kanë të bëjnë me komunikimin. Shiko Muller, Page dhe Kuerbis, 2004, 170.

8 Shiko Hackett dhe Carroll 2006, Napoli 2007, për më shumë informacion rreth “mjedisit kulturor”, shiko Duncan 1999.

Më saktësisht, me termin “aktivizëm” kuptojmë çdo përpjekje për ndryshim,⁹ dhe me frazën “aktivizëm mediatik” kuptojmë çdo lëvizje aktiviste që synon ndryshimin në favor të interesit publik në sektorin e medias dhe komunikimit masiv.¹⁰ Ne po përdorim këtu përkufizimin e aktivizmit të medias të dhënë nga Hoynes: *“Aktivistët e medias kanë për synim që të ndryshojnë strukturën dhe përmbajtjen e mediave kryesore, dhe për të arritur këtë qëllim përdorin një shumëllojshmëri taktikash për të bërë për vete apo për t’i bërë presion gazetarëve, për të tërhequr vëmendjen e publikut ndaj mangësive të mediave kryesore, për të fituar mbështetjen e publikut për politika që synojnë promovimin e diversitetit në pronësinë dhe përmbajtjen e medias, si dhe për të mbështetur mediat alternative në të gjitha llojet e platformave mediatike”* (2005, Freedman 2017, 1). Ndërkohë, theksohet se aktivizmi mediatik ka të bëjë gjithashtu me një sërë çështjesh të lidhura me median, duke përfshirë edhe komunikimin në platforma jo-gazetareske, dhe se ai synon të ndikojë mbi grupe të ndryshme, që nga gazetarët, deri tek ligjvënësit dhe institucionet shtetërore, në bashkëpunim me grupe të ndryshme qytetarësh dhe publikun e gjerë.

Aktivizmi mediatik ka të bëjë me përpjekjet për të ndikuar te institucionet ekzistuese, por edhe me përpjekjet për të ndërtuar praktika mediatike alternative dhe për të zhvilluar ndjeshmërinë të përdoruesit e medias.

Ne jemi dakord me mendimin se rezultatet e aktivizmit mediatik, d.m.th. lufta për të drejtat e komunikimit / demokratizimin e medias / drejtësinë mediatike/ reformat mediatike, do të përcaktojnë rrjedhën e historisë. Siç vënë në dukje Hackett dhe Carroll: *“Duke pasur parasysh rolin themelor që luan masmedia në formëzimin e çështjeve dhe ndërgjegjes publike, përpjekjet për të demokratizuar komunikimin ndikojnë direkt mbi një gamë të gjerë çështjesh politike, shoqërore dhe ekonomike – që nga zhvillimi urban deri tek shpallja e luftës”* (2004, -). Aktivizmi mediatik përfshin përpjekje për të ushtruar ndikim mbi institucionet respektive (përmes reformave të politikave mediatike dhe fushatave për ndryshimin e përmbajtjes në media, si për shembull në lidhje me përfaqësimin e minoriteteve në lajme), identifikimin e praktikave alternative në media, dhe rritjen e nivelit të ndjeshmërisë të përdoruesve të medias (duke mbështetur organe mediatike alternative, demokratike, gjithëpërfshirëse, si dhe duke fuqizuar qytetarët nëpërmjet edukimit mediatik).¹¹

9 Cammaerts e konsideron aktivizmin si aftësi për të realizuar ndryshime historike (2007, 217).

10 Ndonëse termi aktivizëm mediatik përdoret shpesh edhe për të nënkuptuar përdorimin e medias dhe teknologjisë së informacionit për të realizuar ndryshime shoqërore në çdo fushë, në këtë studim nuk do ta marrim në konsideratë këtë aspekt të aktivizmit mediatik.

11 Për më shumë informacion shiko Hackett dhe Carroll 2004.

II.

NJË PREZANTIM I SHKURTËR I HISTORISË SË GJATË TË AKTIVIZMIT MEDIATIK

Aktivizmi mediatik ka ekzistuar në periudha dhe situata historike shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Aktivizmi shpesh buronte nga sindikata, grupe për mbrojtjen të drejtave të njeriut dhe lëvizje shoqërore. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që nga vitet 1920 aktivistët kundërshtuan komercializimin e medias dhe kërkuan që të krijohet një sektor mediatik jofitimprurës, por lëvizjet kundër diskriminimit racor dhe për mbrojtjen e të drejtave të grave në vitet 1960 dhe 1970 u karakterizuan nga përpjekje më serioze në lidhje me median dhe komunikimin.¹² Ndërkohë, edhe dalja në skenë e televizionit kabllor dhe mundësitë e reja për transmetimin e programeve jofitimprurëse mbi kulturën, arsimin dhe çështje publike nxitën akoma më shumë advokimin për media alternative (Kranich 2004, 200). Lëvizja antikapitaliste e nxitur nga "ndjenjat nacionaliste në vende të botës së tretë" ishte shtysa kryesore për iniciativën ndërqeveritare Rendi i Ri Botëror i Informacionit dhe Komunikimit (*New World Information & Communication Order* - NWICO) që luajti një rol të madh në aktivizmin mediatik në vitet 1970 dhe 1980.¹³ Në Brazil, në vitet 1980, kishte dy lëvizje masive: një lëvizje për media komunitare, për rregullimin dhe legjitimimin e radiove komunitare, që më parë konsideroheshin të paligjshme dhe luftoheshin nga autoritetet; dhe një lëvizje për pluralizimin e transmetimeve, kundër dominimit të konglomerateve private të medias. Të dyja iniciativat u nisën nga pedagogë dhe studentë të universiteteve, dhe që

Aktivizmi mediatik ka ekzistuar në periudha dhe kontekste shumë të ndryshme historike. Shpesh herë është mbështetur te sindikatat profesionale dhe lëvizjet për të drejtat e njeriut ose lëvizjet sociale.

12 Shiko McChesney 2008 dhe Mueller, Kuerbis, & Page 2004. Në këtë periudhë fokusi i aktivistëve (shpesh nga pakicat politike) ishte mbi përmbajtjen e medias dhe u rrit shumë numri i organizatave për lobim. (Mueller 2004, 37).

13 Qëndrimi armiqësor nga ana e qeverive të Mbretërisë së Bashkuar dhe SHBA-së, hegjemonia globale e tregut liberal dhe komercialist, si dhe tërheqja nga qëndrimet socialiste dhe anti-imperialiste të lëvizjeve nacionaliste bënë që elitat politike ta braktisnin NWICO dhe të bashkëpunonin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me kompanitë globale të medias. (Hackett 2016).

të dyja rezultuan në ndryshime pozitive në legjislacion.¹⁴ Përafërsisht në po të njëjtën kohë edhe Koreja u përfshi nga protesta kundër njëanshmërisë të radio-televizionit publik që treguan fuqinë e aksionit kolektiv dhe nxitën edhe lëvizje e protesta të tjera të publikut.¹⁵

Në vendet e Evropës perëndimore kultura demokratike e administratës publike (shërbimi publik), që në disa raste shoqërohej edhe nga nacionalizmi kulturor, është përdorur për të nxitur financimin e shtetit për media alternative demokratike dhe komunitare (Hackett 2016). Nga ana tjetër, edhe lufta politike e klasës punëtore dhe partive socialdemokrate në Evropën perëndimore kanë shërbyer si shtylla kurrizore e shtypit të majtë dhe presionit për reforma të politikave mediatike.¹⁶ Në Irlandën e Veriut, duke nisur që nga fundi i viteve 1970, mediat alternative dhe shprehjet e protestës nëpërmjet pikturave murale dhe artit të rrugës, ishin pjesë e strategjisë për shprehjen e pikëpamjeve alternative politike përkundër paragjyqimeve strukturore dhe njëanshmërisë të mediave kryesore kundër republikanëve dhe grupeve të tjera disidente (Hoey 2018, 4).¹⁷ Aktivizmi mediatik u shfaq edhe në situata dhe vende të papritura, si në rastin e gazetës Vedem, që u krijua nga disa adoleshentë në vitet 1942-1944 në kampin e përqendrimit Theresienstadt (sot ndodhet në territorin e Republikës Çeke), çka “demonstron në mënyrë unike aftësinë dhe nevojën njerëzore për komunikim” (Carpentier, 2011, 10).

Shumë vite më pas, në kohën e shpërbërjes dhe luftërave në ish-Jugosllavi në vitet 1990, aktivizmi mediatik kishte një komponent të fortë anti-luftë dhe ofroi alternativa përkundër ideologjisë etno-nacionaliste që dominonte sferën publike. Një nga shembujt e angazhimit anti-luftë duke përdorur forma alternative të medias ishte gazeta ARKzin në Kroaci – u botuan 93 numra ku shkruhej mbi politikën, kulturën, teorinë dhe artin.¹⁸ Pas luftës, lëvizja qytetare në rajon është forcuar më tej dhe ka mbështetur gazetarinë e pavarur,¹⁹ ka kërkuar zhvillimin e reformave mediatike në shërbim të interesit publik,²⁰ dhe forcimin e kapaciteteve të pjesëmarrjes qytetare, duke përfshirë edhe reformat në media.²¹

Aktivistët mediatikë janë angazhuar në çështje me interes publik lidhur me median dhe komunikimin, siç janë përfaqësimi i grupeve të pakicave në përmbajtjen mediatike dhe politikave të punësimit, mbështetja e mediave alternative (p.sh., komunitare), financimi dhe pronësia e mediave, aksesimi në informacionin publik, edukimi mediatik dhe shumë çështje të tjera.

14 Shiko Custòdio 2017, 64.

15 Shiko Young-han 2001.

16 Për shembull, CPBF në Britani, e themeluar në vitin 1979, ishte një “aleancë e krijuar nga gazetarë, akademikë, punonjës të sektorit publik që përballeshin me qëndrime armiqësore në shtyp, dhe nga sindikata të medias së shkruar që kërcënoheshin nga asgjësimi teknologjik” (Hackett 2016).

17 Që nga fillimi i procesit të paqes, në fillim të viteve 1990, këto zëra janë integruar gjithnjë e më shumë në sferën e mediave kryesore (Hoey, 2018, 5).

18 Shiko faqen e internetit të ARKzin, at: <https://monoskop.org/Arkzin>.

19 Të tilla raste janë, për shembull dorëheqjet e gazetarëve të B92 pasi ky organ mediatik u vu forcërisht nën kontrollin e një zyrtari qeveritar në vitin 1999, si dhe protestat e komunitetit gazetaresk dhe qytetarëve kundër ndërhyrjeve qeveritare tek frekuencat e transmetimit të B92. B92 ishte asokohe një nga të paktat media të pavarura në Serbi, në një situatë represioni të fortë qeveritar. Lexo një artikull të OsservatorioBalcani e CaucasoTranseuropa (OBCT), tek <https://www.balcanicaucaso.org/bhs/zone/Srbija/Srbija-kako-je-nastao-i-nestao-Radio-B92-163188>.

20 Për shembull, në vitin 2013, shoqatat e gazetarëve, organizata të shoqërisë civile dhe media të pavarura ndaluan miratimin e ndryshimeve legjislative që synonin të reduktonin aksesin tek informacioni publik në Bosnjë Hercegovinë (Dekić 2013).

21 Në Malin e Zi edukimi mediatik është futur që në vitin 2009 si lëndë me zgjedhje për nxënësit e gjimnazit të moshave 16 dhe 17 vjeçare.

Në ditët tona, duke u gjendur para presionit të qeverive autoritare, shoqëria civile në Hungari dhe Poloni po i reziston kapjes së medias dhe kufizimeve të lirisë së medias, shpesh përmes protestave masive. Për shembull, në vitin 2016 në Varshavë mijëra qytetarë bllokuan ndërtesën e parlamentit në shenjë proteste ndaj planeve të qeverisë për të kufizuar aksesin e gazetarëve në seancat e parlamentit.²² Në kuadër të këtij aktivizmi mediatic iu drejtuan edhe lutje e kërkesa Bashkimit Evropian për të ndërhyrë dhe për të ushtruar presion për të mbrojtur lirinë e medias.²³

Aktivistët e medias i kanë përqendruar përpjekjet e tyre mbi një sërë çështjesh me interes publik në lidhje me median dhe komunikimin, që nga pasqyrimi dhe përfaqësimi i minoriteteve në media, diversiteti në politikat e punësimit, promovimi i mediave alternative (p.sh. mediave të komunitetit – duke përfshirë ndryshime në legjislacion dhe sigurimin e frekuencave të transmetimit),²⁴ deri tek çështje që kanë të bëjnë me pavarësinë dhe rolin e radio televizionit publik, si transparenca e pronësisë dhe financimit të medias, aksesin në informacion publik, siguria dhe mbrojtja e gazetarëve, vëzhgimi i medias (monitorimi dhe kundërvënja ndaj njëanshmërisë në media, lufta kundër stereotipeve dhe dezinformacionit, etj.), përmirësimi i nivelit të edukimit mediatic, dhe shumë tema të tjera.

Zakonisht aktivizmi mediatic është iniciuar dhe udhëhequr nga organizata të shoqërisë civile.²⁵ Kështu për shembull, gjatë dekadave të fundit në SHBA, numri i organizatave në mbrojtje të interesit publik dhe aktivitetet politike në fushën e komunikimit janë shtuar në mënyrë dramatike.²⁶ Në këtë proces nuk janë angazhuar vetëm organizata të shoqërisë civile me prirje të majtë. Për shembull, një çështje gjyqësore që nisi me iniciativën e një komuniteti fetar në SHBA rezultoi në heqjen e licencës së transmetimit të një televizioni me përmbajtje raciste, por gjithashtu i njohu qytetarëve të drejtën ligjore për të ndikuar mbi të gjitha procedurat e enteve rregullatore të sektorit të medias.²⁷

Në disa raste aktivitete të aktivizmit mediatic janë zhvilluar me pjesëmarrje të gjerë të qytetarëve. Rasti që përmendet më shpesh në këtë drejtim ka të bëjë me një fushatë popullore në SHBA, në vitin 2003, me pjesëmarrjen e qindra mijëra personave (madje disa burime thonë se u përfshinë rreth dy milionë qytetarë) nga publiku që bënë telefonata dhe nënshkruan një peticion për të

Aktivizmi mediatic ka sjellë ndryshime të domosdoshme dhe pozitive në politikat dhe praktikat e mediave, si dhe ka ndalur shumë ndryshime negative.

Iniciativat e aktivizmit mediatic kanë treguar se ka një numër të madh njerëzish që mbështesin reforma mediatike, përfshirë jo vetëm profesionistët e mediave dhe organizatat e gazetarëve, por edhe kërkuar, aktivistë të të drejtave civile, bibliotekarë, edukatorë, prindër, studentë, me një fjalë – secili prej nesh.

22 Mund të shikoni një kronikë nga AlJazeera tek: <https://www.aljazeera.com/news/2016/12/17/thousands-protest-new-media-restrictions-in-poland>.

23 Shiko lutjet dhe kërkesat në lidhje me pronësinë qeveritare të organeve mediatike, në një raport nga Euractive, tek: <https://www.euractiv.com/section/media/news/hungary-may-see-takeovers-of-last-free-media-experts-warn/>.

24 Për një tablo të stacioneve të radios në të gjithë botën që janë bërë shembull për komunikim gjithëpërfshirës shiko Dagron 2001. Shiko edhe materialin e redaktuar nga Pajnik dhe Downing (2008) mbi çfarë mund të konsiderohet media e shoqërisë civile.

25 Ka të dhëna se kjo ka ndodhur si në SHBA ashtu në vende të botës së tretë.

26 Shiko për shembull Napoli 2007, por studimi përqendrohet vetëm tek analizimi i literaturës në anglisht dhe ka të bëjë kryesisht me SHBA. Shiko edhe Rentschler 2004.

27 Në vitin 1964, Kisha e Bashkuar e Krishtit (United Church of Christ - UCC) kërkoi nga gjykata që t'i hiqej licenca e transmetimit një televizioni me frymë raciste në Misisipi. Për më shumë shiko Horowitz 1997.

ndaluar ndryshimet e ligjit mbi pronësinë e medias që do të çonte në zbutjen e masave për parandalimin e përqendrimit të pronësisë së medias në pak duar. Një mobilizim kaq i gjerë tregoi zhgënjimin e publikut ndaj politikave mediatike të “tregut të lirë” dhe ndërgjegjësimin në rritje se media po ndikohet gjithnjë e më shumë nga korporatat dhe interesat politike.²⁸

Përgjatë rrjedhës së historisë, aktivizmi mediatik ka kaluar nëpër shumë peripeci dhe probleme, duke përfshirë mungesën e eksperiencës dhe njohurive të aktivistëve në përballje me zhvillime të mëdha dhe të vazhdueshme teknologjike,²⁹ vështirësi në mobilizimin e qytetarëve për tema që lidhen me median, si dhe mungesë burimesh dhe kapacitetesh në përballje me interesat politike dhe komerciale që ndikojnë në politika dhe praktika mediatike. Për pasojë, aktivizmi mediatik nuk arriti dot që t’i frenojë tendencat negative në gazetari dhe media gjatë dekadave të fundit në mbarë botën. Siç thotë edhe McChesney, edhe propozimet më radikale për reforma në SHBA nuk përbëjnë ndonjë kërcënim për dominimin e korporatave të sistemit mediatik (2008). Po kështu, edhe në Kore, efektet pozitive të aktivizmit mediatik u konsideruan si “lëshime të vogla në kuadër të reformave neoliberales nga të cilat përfituan më shumë mediat dhe korporatat e teknologjisë së informacionit” (Hadl dhe Dongwon, 2008, 99).

Sidoqoftë, aktivizmi mediatik ka sjellë ndryshime të rëndësishme pozitive (dhe ka frenuar shumë tendenca negative) të politikave dhe praktikave të medias, duke përfshirë demokratizimin e përgjithshëm të proceseve të politikëbërjes në fushën e komunikimit, kontributin e dhënë në zhvillimin e sektorit të medias së komuniteteve, krijimin e një klime më gjithëpërfshirëse në mediat kryesore, mbështetjen për mediat e shërbimit publik dhe programet e tyre, krijimi i standardeve për akses në informacionin publik dhe transparencën e medias, si dhe shumë çështje të tjera. Po kështu, iniciativat e aktivizmit të medias kanë treguar se ekziston një grup i madh profesionistësh që interesohet për reformat në media ku përfshihen jo vetëm punonjësit e medias dhe shoqatat e gazetarëve, por edhe studiues, aktivistë të të drejtave civile, punonjës bibliotekash,³⁰ arsimtarë, prindër, studentë; domethënë - të gjithë ne.

28 Shiko McChesney 2008, Hackett dhe Carroll 2004, Klinenberg 2007.

29 Shiko McChesney 2008.

30 Për më shumë informacion mbi mënyrën se si punonjësit e bibliotekave përfshihen në diskutime publike mbi çështje që kanë të bëjnë me median në SHBA, shiko Kranich 2004.

III.

SHEMBUJ TË MIRË TË AKTIVIZMIT MEDIATIK

Në këtë kapitull synojmë të prezantojmë disa nga shembujt më të mirë të aktivizmit mediatic. Paraqitja e një liste të gjatë me të gjithë shembujt e tillë nuk është objektivi i këtij projekti, ndaj synojmë të paraqesim raste të aktivizmit mediatic që ilustrjnë një sërë temash dhe lloje të ndryshme aktivizmi mediatic, duke pasqyruar edhe diversitetin në vendndodhjet gjeografike dhe kontekstet social-politike. Për çdo nëntitull paraqitet nga një shembull i veçantë aktivizmi mediatic.

3.1. PLATFORMAT ALTERNATIVE

Platformat alternative të aktivizmit të medias ofrojnë përmbajtje mediatike të krijuar nga qytetarë ose gazetarë profesionistë. Platformat alternative gazetareske funksionojnë si platforma të pavarura nga ndërhyrjet e qeverive dhe korporatave, dhe kryesisht e kryejnë aktivitetin e tyre mbi baza jofitimprurëse, duke i shërbyer komuniteteve të veçanta ose duke bërë gazetari investigative. Këto funksione shpesh mbivendosen, pasi si mediat e komunitetit ashtu edhe platformat e gazetarisë investigative janë parimisht organet mediatike më të pavarura që trajtojnë tema dhe paraqesin këndvështrime që neglizhohen nga mediat kryesore. Ne i konsiderojmë të gjitha këto platforma si përçuese të aktivizmit mediatic, pasi ofrojnë informacion alternativ në raport me përmbajtjen dominuese të mediave kryesore dhe kontribuojnë në pluralizmin e debatit publik. Këto platforma financohen kryesisht nga fonde zhvillimi dhe donatorë ndërkombëtarë, por mund të mbështeten financiarisht edhe nga komunitetet që cilave u shërbejnë. Disa prej tyre mbahen pjesërisht në këmbë nga angazhimi dhe puna vullnetare e qytetarëve.

Platformat alternative ofrojnë një hapësirë të sigurtë dhe të pavarur për subversion politik dhe kundër-narrativa. Këto platforma varen nga puna bashkëpunuese e gazetarëve qytetarë, ndërsa mund të ketë ose jo ndonjë formë redaktimi të përmbajtjes.

3.1.1. Platformat me përmbajtje alternative dhe shërbime alternative në internet

Në shoqëri autoritare, por edhe në vende ku mbizotëron ideologjia neoliberales, platformat alternative ofrojnë një hapësirë të sigurt dhe të pavarur për shpalosjen e pikëpamjeve politike disidente dhe kundërvënien ndaj narrativave mbizotëruese. Këto platforma funksionojnë falë punës së përbashkët të gazetarëve qytetarë, ndërkohë që në disa prej tyre mund të ketë edhe ndonjë formë redaktimi të përmbajtjes para publikimit. Shumë prej këtyre platformave, si Indymedia apo Mosireen, janë krijuar gjatë protestave qytetare apo trazirave sociale. Shumica e tyre mbështeten tek prodhimi i përmbajtjes me pjesëmarrje vullnetare. Në këtë kategori kemi futur edhe blogje që ofrojnë këndështrime unike për tema me interes publik (Shiko tabelën 1 për disa nga këto shembuj).

Tabela 1: **SHEMBUJ TË PLATFORMAVE ALTERNATIVE**

Emri	Fusha tematike	Lloji i platformës/ projektit	Organizatorët kryesorë	Shtrirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Zëra Globalë (Global voices)	Pluralizmi mediatik, pjesëmarrja digjitale	Raportimi mbi grupe të nënpërfaqësuar	Në fillim, Universiteti Harvard, që nga viti 2008: Organizata Stichting Global Voices	Ndërkombëtare	Massachusetts SHBA Hollandë	2004–2008 2008–deri më sot
Indymedia	Lajme të pavarura, pluralizmi mediatik, pjesëmarrja digjitale, gazetaria qytetare	Platformë ndërkombëtare e internetit për lajme	Qendra e Pavarur e Mediave në Seattle, organizata të ngjashme në mbarë botën	Ndërkombëtare	Seattle, SHBA	1999–2019 (afërsisht)
Jinbonet	Liria e shprehjes, gazetari qytetare, pjesëmarrja digjitale	Ofrues i pavarur i shërbimit të internetit (email, publikim faqesh interneti, blogje komuniteti) për lëvizje sociale, sindikata dhe aktivistë progresivë	Organizata jo-fitimprurëse Rjeti Progresiv Korean (Korean Progressive Network) Jinbonet	Kombëtare	Koreja e Jugut	1998–deri më sot

Mosireen	Lajme të pavarura, pluralizëm politik, gazetari qytetare	Dokumentimi dhe publikimi i fotove dhe videove mbi revolucionin e vitit 2011 në Egjipt	Gazetarë qytetarë	Kombëtare	Egjipt	2011–2018
Blog "In Media Res" (Boris Vezjak)	Media dhe demokracia, media dhe shoqëria	Publikim javor (ose më shpesh) blogje/opinione mbi median dhe demokracinë, shpërndarja me e-mail; ribotime në faqen e internetit të revistës së përjavshme Mladina	Pedagogu universitar Boris Vezjak	Kombëtare	Sloveni	2008–deri më sot
Sbunker blog	Lajme të pavarura, mendim kritik	Blog që ofron përmbajtje tematike / këndvështrime të nënpërfaqësuar në media	OJQ Sbunker	Kombëtare	Kosovë	2017–deri më sot

Shembull: RASTI I INDYMEDIA (SHBA dhe më gjerë)

Indymedia fillimisht publikoi përmbajtje mediatike mbi protestat kundër takimit të Organizatës Botërore të Tregtisë në Seattle në nëntor 1999, por shpejt u kthye në një pikë referimi për platforma të menaxhuara nga përdorues dhe protestues. Indymedia u krijua si një koalicion i grupeve për drejtësi sociale, grupeve anarkiste, komuniste, socialiste dhe ambientaliste, si dhe sindikatave; kishte një staf bazë të vogël por shpërndante rregullisht përmbajtje mediatike. Në vitet 2000, me ta u bashkuan grupe të tjera aktiviste nga e gjithë bota (në vitin 2014 kishin 175 grupe anëtare në mbarë botën Girauld, 2014)³¹ me bindje politike që varionin nga socialiste deri në radikalizëm antikapitalist. Në fillim, Indymedia i lejonte të gjithë që të publikonin përmbajtje mediatike pa filtrim, por në vitet 2000 filluan të përdorin një formë unike redaktimi nga një grup redaksional që hiqte nga faqja materiale që konsideroheshin si informacione të rreme, shpifje ose të papërshtatshme dhe i postonte në një faqe të veçantë të titulluar "artikuj të fsheshur" (Atton 2010, 8). Indymedia arriti atë që nuk mundën ta bënin dot një numër i madh platformash online të lëvizjeve sociale të asaj kohe, pra arriti një shtrirje të madhe globale dhe siguroi një jetëgjatësi rreth 20-vjeçare. Strategjia e tyre rezultoi e suksesshme ngaqë përfshinë në gjirin e tyre grupe të shumta proteste, zgjeruan agjendën e protestës dhe arritën të krijojnë një rrjet ndërkombëtar bashkëpunimi. Sidoqoftë, pas një fare kohe Indymedia dhe platforma të tjera të ngjashme u zhdukën si pasojë e daljes në skenë të kompanive komerciale të mediave sociale. Disa faqe interneti të grupeve radikale vazhdojnë ende të funksionojnë, por shtrirja dhe ndikimi i tyre është i kufizuar në zona të veçanta.³²

31 Shumica e këtyre grupeve ishin nga SHBA dhe Evropa, por kishte edhe nga rajone të tjera të botës, në një numër më të vogël (Atton 2010, 8).

32 Një shembull i tillë është Unicorn Riot në SHBA, i njohur për transmetimin e drejtpërdrejtë të protestave dhe qëndrimin kundër racizmit.

3.1.2. Mediat e komunitetit

Në këtë kategori përfshihen ato media që raportojnë për komunitete të nënpërfaqësuar, si për shembull komuna ose zona të largëta, grupe studentore, sindikata, komunitete mbi baza etnike, gjinore, etj. Mediat komunitare angazhojnë anëtarë të vetë komuniteteve në prodhimin dhe menaxhimin e lajmeve. Ka përkufizime të ndryshme se çfarë është një media komunitare, por në këtë raport do t'i konsiderojmë si media me një mision të qartë për t'i shërbyer komunitetit dhe interesit publik, bazuar kryesisht në një model biznesi jofitimprurës. Në parim, ky lloj modeli mund ta ndihmojë median që ta izolojë veten nga interesat komerciale dhe politike, çka duhet të sigurojë përmbajtje mediatike më të pavarur dhe me interes për komunitetin.

Tabela 2: **SHEMBUJ TË MEDIAVE TË KOMUNITETIT**

Emri	Fusha tematike	Lloji i platformës/ projektit	Organizatorët kryesorë	Shtrirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Radio Orange	Përmbajtje e pavarur, e orientuar drejt komunitetit	Një stacion radio dhe advokim herë pas here për politika mediatike që mbështesin mediat jofitimprurëse	Stafi prej një duzinë personash dhe vullnetarë	Lokale dhe kombëtare	Vjenë, Austri	1998–deri më sot (e regjistruar) më parë funksiononte si radio pirate
Telestreet	Lajme të pavarura	Një rrjet televizionesh të vogla	Komunitete vendase	Kombëtare	Itali	2002–deri më sot
Rrjet stacione radio minatorësh	Lajme të pavarura, pluralizëm politik dhe pluralizëm i përfaqësimit në media	Platformë komunikimi për minatorë	Sindikata minatorësh	Kombëtare	Bolivi	1949–1985+
Contre attaque (Kundërsulm, më parë njihet me emrin Nantes Révoltée – Nantë në Revoltë)	Lajme të pavarura, media alternative, aktiviste	Faqe interneti që boton analiza dhe artikuj me qëndrim të fortë editorial me prirje të majtë dhe kritike ndaj qeverisë	Nuk ka	Kryesisht kombëtare, ndonëse është e disponueshme edhe për audiencë më të gjerë dhe ka raportime mbi çështje ndërkombëtare	Nantë, Francë	2012–2022 si Nantes Révoltée; 2022 - deri më sot njihet si Contreattaque

Radio Huayacocotla	Pluralizëm mediatik, lajme lokale, mbrojtje e trashëgimisë kulturore	Shërbime për komunitete indigjene dhe promovimi i ruajtjes së kulturës dhe zhvillim lokal	Në pronësi të një organizate të shoqërisë civile Fomento Cultural y Educativo, A.C.	Rajonale, brenda Meksikës	Meksikë	1965–deri më sot
Forumi i mediave Komunitare në Evropë (Community Media Forum Europe)	Media të komunitetit në Evropë	Platformë për rrjete, federata kombëtare dhe projekte aktive në sektorin e mediave komunitare në Evropë	Mediat e komunitetit dhe shoqatat e tyre në Evropë, duke përfshirë Gjermaninë, Austrinë, Francën, Danimarkën, Slloveninë, etj. 98 anëtarë nga 25 vende evropiane	Evropë	Zyrë në Bruksel	2004–deri më sot
Radio Studenti (Radio Student)	Independent, alternative reporting and debate, alternative culture, music subcultures, social movements, ethnic minorities	Radio studentësh dhe faqe interneti	Studentë të Universitetit të Lubjanës (themelues zyrtar: Organizata Studentore e Universitetit të Lubjanës)	Krahina e Lubjanës	Lubjanë, Slloveni	1969–deri më sot

Ndonëse mediat e komunitetit shpesh financohen nga audienca e tyre, burime të tjera të ardhurash përfshijnë donacione filantropike, financime nga agjenci ndërkombëtare zhvillimi, deri diku edhe nga reklamat (por në disa vende kjo ndalohet me ligj), madje edhe nga qeveritë. Komunitete të ndryshme mund të gëzojnë nivele të ndryshme pronësie mbi mediat e tyre komunitare. Rrjeti i stacioneve radio të minierave në Bolivi është një nga shembujt më të hershëm të një niveli të lartë të pronësisë nga ana e komunitetit, pasi ishte vetë komuniteti që e konceptoi, krijoi, menaxhoi, drejtoi teknikisht, financoi dhe mirëmbajti këtë rrjet (Dagron, 2008, 16).³³

Historikisht, mediat e komunitetit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në plotësimin e nevojave të komunikimit të publikut, duke publikuar vazhdimisht raportime mbi komunitete dhe çështje të neglizhuara si nga mediat private dhe ato publike. Një nga shembujt më të hershëm është rrjeti i stacioneve të radios Pacifica në SHBA, që promovoi një ideologji pacifiste gjatë Luftës së Dytë Botërore. Shumë vite më vonë, në vitin 1967, programi televiziv Sfida për Ndryshim që u transmetua në Kanada demokratizoi procesin e prodhimit mediatik duke realizuar dokumentarë në bashkëpunim me kineastë. Në vendet

³³ Për një tablo të përgjithshme të stacioneve të radios në mbarë botën që mund të merren shembull për komunikimin pjesëmarrës, shikoni Dagron 2001. Shiko gjithashtu edhe materialin e redaktuar nga Pajnik dhe Downing (2008) mbi çfarë mund të quhet media e shoqërisë civile

e Evropës Perëndimore dhe Qendrore, mediat e para komunitare filluan të shfaqen rreth viteve '60 dhe '70, kryesisht si media pirate, madje historia e tyre karakterizohet nga një luftë e gjatë për legalizim, dhe së fundmi nga kërkesat për mbështetje të vazhdueshme financiare nga fonde publike. Një listë e hartuar nga koalicioni CMFE dhe Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore në vitin 2012 tregon se kishte gjithsej 2,237 stacione radio komunitare dhe 521 stacione televizive komunitare aktive në të gjithë Evropën.³⁴ Për shembull, faqja e internetit e Kryqit të Kuq zviceran <https://www.migesplus.ch/> ka publikuar një listë me 38 organe mediatike emigrantësh në Zvicër, pra organe mediatike në gjuhën e komuniteteve të emigrantëve mbi tema me interes për anëtarët e këtyre komuniteteve.

Historikisht, mediat komunitare kanë luajtur një rol të rëndësishëm duke raportuar vazhdimisht mbi komunitetet dhe çështjet që janë injoruar si nga media private, ashtu dhe nga ajo publike.

Në rajonin e Evropës Juglindore, sektori i medias komunitare është ende i pazhvilluar, por shumë media të administruara nga organizata të shoqërisë civile dhe të financuara nga donatorë ndërkombëtarë funksionojnë si media komunitare, pasi raportojnë mbi çështje me interes publik dhe me rëndësi për komunitete lokale të neglizhuara nga media tradicionale.³⁵ Një nga përjashtimet është edhe Radio Studenti në Lubjanë (Slloveni), si një nga mediat më të vjetra të komunitetit në Evropë, e krijuar në vitin 1969 në vazhden e protestave studentore. Kjo radio vazhdon akoma të ofrojë programe jokomerciale dhe t'i bëjë jehonë zërit të studentëve dhe grupeve të nënpërfaqësuar në media në Slloveni.³⁶

Një numër shoqatash kombëtare dhe ndërkombëtare të mediave të komunitetit, si Shoqata e Mediave të Komunitetit (MB), Aleanca e Televizionit Komunitar Austri, Forumi i Radiove Komunitare në Evropë, dhe Shoqata Botërore e Transmetuesve të Radiove Komunitare ofrojnë mbështetje dhe lobim për një përshtatje më të mirë të politikave në favor të mediave të komunitetit.

Shembull: [RASTI I TELESTREET](#) (Itali)

Telestreet është një rrjet grupesh aktiviste që u ofrojnë qytetarëve lajme alternative. Telestreet nisi si një lëvizje në zonat metropolitane italiane, së pari me stacionin televiziv Orfeo që transmetonte vetëm pak orë në ditë dhe mbulonte me valë një zonë me rreze prej 200 metrash. U krijua nga teoricieni dhe aktivisti i medias Franko "Bifo" Berardi. Më vonë lëvizja e zgjeroi aktivitetin duke përfshirë rreth njëqind stacione të vogla televizive në të gjithë Italinë. Këto mikrotelevizione pirate me mbulim shumë të kufizuar territori u krijuan si reagim ndaj kontrollit të mediave nga kryeministri i atëhershëm Berlusconi. Këto stacione ndihmojnë njëri-tjetrin nga ana teknike dhe kanë të drejtë të përdornin arkivën e përbashkët të kronikave dhe emisioneve në internet, duke rritur kështu mbulimin kombëtar të rrjetit dhe duke siguruar infrastrukturë të qëndrueshme pavarësisht nga mungesa e fondeve dhe pajisjeve teknike (Renzi 2011, 36).

34 Informacion i marrë nga CMFE, nga: <https://www.cmfe.eu/about>.

35 Ledanac, për shembull, përmend Forum zena Prijepolje, faqen Buka Banjaluka dhe Krik Serbia si shembuj të mediave të shoqërisë civile (2016, 136-139), por ka edhe shumë të tjera.

36 Për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit të Radio Student, tek: <https://radiostudent.si/info>.

3.1.3. Organet e pavarura të medias

Projektet dhe platformat gazetareske që ofrojnë raportim të pavarur në vende të sunduara nga qeveri represive janë baza të domosdoshme të rezistencës dhe luftës për demokraci. Po kështu, në sisteme mediatike të kapura nga grupe interesi politik ose ekonomik nëpërmjet financimit dhe marrëdhënieve të pronësisë, vetëm mediat e pavarura mund të kërkojnë llogari nga pushteti dhe të raportojnë mbi tema dhe subjekte të neglizhuara.

Mediat e pavarura po i kërkojnë llogari pushtetit dhe po mbulojnë temat dhe perspektivat e shpërfillura.

Tabela 3: **SHEMBUJ TË ORGANEVE TË PAVARURA TË MEDIAS**

Emri	Fusha tematike	Lloji i platformës/ projektit	Organizatorët kryesorë	Shtrirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
AcTVism	Lajme të pavarura, pluralizëm politik	Media online për tema me interes publik	Organizata AcTVism	Ndërkombëtare	Mynih, Gjermani	2014–deri më sot
El Faro	Lajme të pavarura, pluralizëm politik	Raportim mbi korrupsionin, organizata kriminale, etj	Kompania e medias Trípode S.A. de C.V.	Ndërkombëtare (me fokus mbi Amerikën qendore)	El Salvador deri më 2023/ San José (Kosta Rika)	1998–deri më sot
Rappler	Lajme të pavarura, pluralizëm politik	Ofrues i pavarur i lajmeve në internet	Rappler Holding Corporation	Kombëtare +	Filipine	2012–deri më sot
Malaysiakini	Lajme të pavarura, pluralizëm politik	Ofrues i pavarur i lajmeve në internet	Mikini Group SdnBhd (publikues), shumica e aksioneve në pronësi të redaktorëve dhe gazetarëve	Kombëtare +	Malajzi	1999–deri më sot
Ninxha media (Mídia Ninja) (Nuk ka faqe interneti, mund të shikoni Menezes Teixeira, 2020)	Lajme të pavarura, pluralizëm politik	Publikimi i lajmeve dhe komenteve alternative	Dy gazetarë, që punonin për rrjetin e prodhimit kulturor Fora do Eixo	Kombëtare (Brazil)	Brazil	2011

Bianet	Pluralizmi mediatik, liria e medias	Publikimi i përm-bajtjes së pavarur, veçanërisht për dhe rreth grupeve të nënpërfaqësura	Fondacioni i Komunikimit IPS	I drejtohet audiencës kombëtare, por përm-bajtja ka të bëjë me zona të gjera gjeografike	Turqi	2001–deri më sot
Kosovo 2.0	Gazetari e pavarur, pluralizëm mediatik	Platformë që ofron përm-bajtje gazetareske, raporte mbi artin dhe kulturën, duke nxitur mendimin kritik	Kosovo 2.0	Kombëtare	Kosovë	2010–deri më sot
Preportr Çohu	Pluralizëm mediatik, Lajme të pavarura	Faqe interneti që ofron përm-bajtje unike	OJQ Çohu	Kombëtare	Kosovë	2005–deri më sot
Zurnal Revistë në internet	Pluralizëm mediatik, lajme të pavarura	Media në internet që ofron përm-bajtje tërheqëse dhe me interes publik	Stafi i OJQ-së CRMA prej 7 personash dhe kontribues të jashtëm	Kombëtare, megjithëse mbulojnë edhe çështje rajonale dhe globale	Bosnjë Hercegovinë	2009–deri më sot

Shembull: [RASTI I KOSOVO 2.0](#)

Kosovo 2.0 u themelua në vitin 2010 për të ofruar një hapësirë për narrativa alternative, analiza të detajuara, histori personale dhe këndvështrime të ndryshme. Ajo fitoi popullaritet në Kosovë falë përqasjes unike në shkrime dhe artikuj, si dhe përkushtimit ndaj mendimit kritik dhe dialogut. Kosovo 2.0 përdor metoda multimediale duke kombinuar artikuj, foto ese, video dhe projekte artistike për të mbuluar një gamë sa më të gjerë fushash dhe temash, duke përfshirë drejtësinë sociale, politikën, gjininë, kulturën dhe të drejtat e njeriut. Kosovo 2.0 është kthyer një platformë ku shkrimtarë, artistë, dhe aktivistë të rinj ekspozojnë dhe publikojnë punët e tyre.

3.1.4. Projektet, qendrat dhe rrjetet rajonale / ndërkombëtare të gazetarisë investigative

Rrjetet dhe qendrat e gazetarëve, si Konsorciumi Ndërkombëtar i Gazetarisë Investigative (ICIJ), Projekti i Raportimit të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (OCCRP) ose Qendra për Gazetari Investigative (Bosnjë Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi) krijojnë mundësi për realizimin e investigimeve që kërkojnë shumë kohë, fonde, dhe bashkëpunim ndërkufitar. Këto projekte nuk mund të realizohen dot nga media të tjera për arsye komercializimi, servilizmi politik apo thjesht mungesë burimesh.

Qendrat dhe rrjetet gazetareske mundësojnë investigime të vështira, të gjata, të kushtueshme, shpeshherë të shtrira në disa vende, të cilat në media të tjera do të ishin të pamundura për shkak të komercializimit, nënshtrimit politik, ose thjesht mungesës së burimeve.

Tabela 4: **SHEMBUJ TË QENDRAVE / RRJETEVE / PROJEKTEVE TË GAZETARISË INVESTIGATIVE**

Emri	Fusha tematike	Lloji i platformës/ projektit	Organizatorët kryesorë	Shtirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Projekti Pegasus / Projekti Daphne	Gazetari investigative, Investigime ndërkufitare	Projekte gazetarie	Organizata Forbidden stories (Lajme të ndaluara)	Ndërkombëtare	Paris, Francë	2020–2021/2018
Rrjeti Global i Gazetarëve Investigativë (Global Investigative Journalism Network)	Gazetari investigative	Mbështetje dhe promovim i gazetarisë investigative (me trajnime, shkëmbime, krijim rrjeti, etj.)	Mbi 75 organizata të pavarura gazetarie	Ndërkombëtare	Uashington, SHBA	2003–deri më sot
Konsorciumi Ndërkombëtar i Gazetarisë Investigative (International Consortium of Investigative Journalism ICIJ)	Gazetari investigative, Investigime ndërkufitare	Rrjet gazetarësh dhe organizatash të medias që merren me gazetari investigative	Qendra për Integritet Publik (Center for Public Integrity - organizata mëmë)	Ndërkombëtare	Uashington, SHBA	1997–deri më sot
Projekti i Raportimit të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (Organised Crime and Corruption Reporting Project OCCRP)	Gazetari investigative, Investigime ndërkufitare	Rrjet i qendrave të pavarura mediatike dhe gazetarëve	E nisur nga gazetarë me përvojë, organizohet nga qendrat e gazetarisë investigative	Ndërkombëtare	Amsterdam, Hollandë	2006–deri më sot
BIRN, Rrjeti i Raportimit Investigativ në Ballkan (Balkan Investigative Reporting Network)	Gazetari investigative, Pluralizëm mediatik	Projekte të raportimit investigativ, çmime gazetarie, bursa	Zyrat e BIRN në të gjithë rajonin, zyra qendrore në Sarajevë	Qendra kombëtare, plus bashkëpunim rajonal	Qendra në 7 vende (Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Rumani)	2005 on (varet nga vendi) – deri më sot

Qendra për Gazetari Investigative (Center for Investigative Journalism CIN)	Gazetari investigative	Platforma e gazetarisë investigative	CIN	Kombëtare	Bosnjë Hercegovinë	2004–deri më sot
Rrjeti i Raportimit mbi Krimin dhe Korrupsionin (Crime and Corruption Reporting Network)	Gazetari investigative, Pluralizëm mediatik	Raportim investigativ mbi krimin dhe korrupsionin	KRIK	Kombëtare, por raportimi përfshin çështje ndërkombëtare	Serbi	2015–deri më sot
Laboratori i Raportimit Investigativ (Investigative Reporting Lab) (në veçanti episodi “Një vrasje në Tetovë”)	Gazetari investigative, akses në informacionin publik	Transmetime TV	Laboratori Kombëtar i Raportimit Investigativ dhe televizioni publik MRT	Kombëtare	Maqedonia e Veriut	2023–deri më sot
Kallxo	Gazetari investigative, gazetari e pavarur	Platformë për gazetari investigative, monitorim, advokim	BIRN dhe Internews Kosovo janë krijuesit e platformës	Kombëtare	Kosovë	2012–deri më sot

Qendrat dhe rrjetet e gazetarisë investigative janë nga të paktat platforma që respektojnë vazhdimisht standardet më të larta profesionale dhe kontribuojnë në informimin e publikut mbi çështje me interes publik.³⁷

Shembull: [RASTI I PROJEKTIT DAPHNE](#)

Daphne ishte një projekt investigativ i një shoqate gazetarie në Francë, Histori të Ndaluara, e cila koordinoi punën e 45 gazetarëve nga 18 organe mediatike pas vrasjes së gazetares investigative malteze Daphne Caruana Galizia më 17 tetor 2017. Gazetarët mbledhën dhe shkëmbyen një numër të madh informacionesh e dokumentesh, dhe më pas artikujt u publikuan në organe mediatike në mbarë botën. Ky ishte projekti i parë i iniciativës gazetareske ndërkombëtare Histori të Ndaluara, që bazohen mbi idenë se bashkëpunimi për gazetari investigative është mbrojtja më e mirë kundër censurës. Shumë nisma të gazetarisë investigative janë pasuar nga procedime penale dhe dorëheqje të zyrtarëve qeveritarë. Pasi u publikuan artikujt investigativë të projektit Daphne, një kriminel pranoi vrasjen e gazetares malteze, u arrestua biznesmeni që lidhej me vrasjen e gazetares, dhe kryeministri i vendit dha dorëheqjen për shkak të lidhjeve të zyrtarëve të qeverisë dhe biznesmenit në fjalë (Simon 2023, 16).

³⁷ Për të parë shembuj shiko raportin vjetor të BIRN.

3.1.5. Mbështetja për iniciativat për media alternative dhe të pavarura

Aktivizmi mediatik përfshin edhe mbështetjen për media alternative, të pavarura, investigative. Kjo mbështetje shprehet me përpjekje për të mbledhur fonde, për të ofruar mbështetje logjistike, teknike dhe ligjore, trajnime, me ofrimin e pajisjeje dhe njohurive, ose çdo veprim tjetër që ndihmon në rritjen e kapaciteteve të mediave alternative për të publikuar përmbajtje mediatike të vlefshme që kontribuojnë në debatin publik.

Tabela 5: **SHEMBUJ TË INICIATIVAVE MBËSHTETËSE PËR MEDIA ALTERNATIVE, TË PAVARURA**

Emri	Fusha tematike	Lloji i platformës/ projekti	Organizatorët kryesorë	Shtirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Novi dan Platforma Dita e re	Fonde për mediat e pavarura	Platformë për donacione për disa media të pavarura jofitim-prurëse (përdoret sistemi i monetizimit të faqes në internet WMS)	OJQ Danas menaxhon platformën Media të tjera pjesëmarrës: Ostro, In Media Res, Drzavljan D, Argument DJND	Kombëtare	Sloveni	2022–deri më sot
Projekti i radios Prometeu	Pluralizmi mediatik, radio komunitare	Mbështetje për radiot komunitare, advokimi për politika favorizuese	Ekipi dhe vullnetarët e projektit të radios Prometeu	Kombëtare	Filadelfia, SHBA	1998–deri më sot
Odbranimo OK radio (Të mbrojmë radion OK)	Pluralizmi mediatik, Financimi i medias	Fushatë mbledhje fondesh nga publiku për radio Vranjen	Shoqata ANEM	Kombëtare	Serbi	1990s–deri më sot

Këto nisma të aktivizmit mediatik po kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve dhe qëndrueshmërinë e platformave të gazetarisë së pavarur dhe investigative, që shpesh gjenden në vështirësi në përballje me një treg mediatik që dominohet nga interesa të veçanta politike dhe korporative.

Shembull: [RASTI I PLATFORMËS NOV DAN](#) (Sloveni)

Nov dan (Ditë e Re) është një platformë digjitale eksperimentale e krijuar në vitin 2022, që synon të kontribuojë në qëndrueshmërinë e gazetarisë së pavarur në Slloveni, duke mbledhur fonde nga publiku për pesë organe mediatike të pavarura në Slloveni, si Ostro, In Media Res, Mešanec, Državljan D, Agrument - DJND. Platforma bazohet në Standardin e Monetizimit të Internetit, optimizimin e eksperiencës së përdoruesve të faqes dhe testimin e strategjive të reja të komunikimit. Krijuese e platformës është organizata joqeveritare Danes je

novdan (Sot është një ditë e re), që angazhohet në çështje si pjesëmarrja digjitale dhe aktivizmi qytetar, transparenca dhe mbikëqyrja publike. Projekti mbështetet nga fondacioni Grant for the Web (Fonde për Internetin) me shumën 46,014 USD. Si projekt me mbledhje fondesh nga publiku, Nov dan i jep mundësi audiencës që të mbështesë ato platforma dhe përmbajtje që vlerëson më shumë, duke nxitur kështu kohezionin në komunitet, ndërkohë që publiku transformohet nga spektatorë individualë në palë të interesuar dhe aktive. Ka edhe shembuj të tjerë të mbledhjes së fondeve nga komuniteti në rajonin e Evropës juglindore. Problemi kryesor që hasin këto iniciativa ka të bëjë me audiencën e ulët të mediave të pavarura, të ardhurat e ulëta të qytetarëve dhe vështirësinë për të siguruar një mbështetje afatgjatë nga ana e qytetarëve, por disa platforma (kryesisht ato që publikojnë materiale origjinale dhe kanë audiencë besnike) arrijnë të sigurojnë një pjesë të rëndësishme të të ardhurave të tyre nëpërmjet mbledhjes së fondeve nga komuniteti.³⁸

RASTI I PROJEKTIT TË RADIOS PROMETEU (SHBA)

Ky është një tjetër shembull frymëzues i mbështetjes për mediat alternative (në këtë rast media komunitare). Prometeu është një OJQ që promovon angazhimin e komunitetit në media, duke u nisur nga parimi që mediat duhet të kontrollohen nga komunitetet të cilave u shërbejnë. Organizata ofron mbështetje për krijimin dhe administrimin e stacioneve radio në komunitete, që nga aplikimi për licenca, ndërtimi i stacioneve radiofonike, deri tek aktivitetet e përditshme. Një nga iniciativat më interesante të Prometeut është organizimi i “ndërtimit të radios nga themeli,” (radio barnraising) ku sipas traditës Amish të ndërtimit të hambarëve në komunitet, qindra vullnetarë (duke përfshirë inxhinierë, gazetarë, avokatë, muzikantë, aktivistë, studentë dhe të tjerë) mblidhen për të ndërtuar një stacion radioje (deri sa të ngrihet antena e radios dhe të fillojë transmetimi) brenda tre ditëve. Këto aktivitete kanë kontribuar në afrimin e komunitetit me stacionet e radios. Prometeu angazhohet gjithashtu edhe në aktivitete lobimi shumëvjeçare për reforma dhe ndryshimin e politikave,³⁹ duke iu kundërvënë lobistëve të kompanive të mëdha private radiotelevizive. Puna e Prometeut mbështetet kryesisht mbi kontributin e praktikantëve dhe vullnetarëve, me angazhimin e 120 personave përgjatë 10 viteve.

Në përmbledhje, platformat alternative, në të gjitha variantet e tyre, janë të domosdoshme për nxitjen dhe forcimin e komunikimit demokratik pa u ndikuar nga interesat e veçanta komerciale dhe politike dhe përçohen nga mediat kryesore. Këto platforma alternative gazetarie dhe komunikimi merren me çështje dhe komunitete të neglizhuara ndër vite dhe nxisin pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e komunikimit.

38 Shiko Hodzic dhe Petkovic 2020, 25.

39 Një nga arritjet më të mëdha të lëvizjes për reformë mediatike në SHBA është rezultati i fushatës dhjetëvjeçare të Prometeut, që në vitin 2010 çoi në miratimin e një ligji që lejoi trasmetimet e qindra radiostacioneve të reja me fuqi të ulët trasmetuese që operohen nga komunitete të ndryshme.

3.2. STUDIME, FUSHATA DHE ADVOKIM PËR REFORMA NË MEDIA

Në këtë kapitull do të fokusohemi në aktivizmin mediatik që synon të luftojë kundër tendencave negative të politikave dhe praktikave mbizotëruese në sektorin e medias dhe komunikimit. Shembujt e aktivizmit mediatik që do të paraqiten në këtë kapitull ekspozojnë mangësi dhe probleme në sistemin e medias dhe kërkojnë ndryshimin e politikave dhe praktikave mediatike. Këto përpjekje janë ndërmarrë nga organizata të përfshira në: a) studime dhe punë kërkimore mbi sektorin e medias dhe komunikimit dhe/ose b) fushata dhe advokim për ndryshime strukturore dhe sistemike. Kapitulli është ndarë në nënkapituj, bazuar në fushat tematike të monitoruara nga këto organizata dhe fushat ku kërkohen reforma.

Aktivizmi mediatik synon gjithashtu të eliminojë politikat dhe praktikat negative në mediat kryesore, nëpërmjet studimit, fushatave dhe advokimit për ndryshime strukturore dhe sistemike.

3.2.1. Koalicionet dhe rrjetet për reforma në media

Në kategorinë e parë të aktivizmit për reformat në media renditen koalicionet, ku organizata të shoqërisë civile dhe qytetarë bashkojnë forcat dhe punojnë së bashku për të ushtruar ndikim mbi politikat dhe institucionet e medias. Disa nga këto koalicione gëzojnë reputacion të mirë si mbështetës të rëndësishëm të reformave në media dhe ofrojnë konsulencë në procesin e zhvillimit të politikave mediatike. Disa nga këto koalicione janë krijuar për të realizuar shkëmbime midis partnerëve (të përmbajtjeve mediatike, përvojave, njohurive), për të organizuar fushata publike dhe rritje të kapaciteteve të anëtarëve të tyre për aktivizëm mediatik. Disa nga këto shembuj janë paraqitur në tabelën 6.

Tabela 6: **SHEMBUJ TË RRJETEVE DHE KOALICIONEVE PËR REFORMA NË MEDIA**

Emri	Fusha tematike	Lloji i platformës/ projekti	Organizatorët kryesorë	Shtirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Shoqata për Komunikim Progresiv (Association for Progressive Communication APC)	Fuqizim kolektiv, përfshirje digjitale, administrimi i internetit si një e mirë publike, zhvillimi i barabartë njerëzor, drejtësi sociale, procese politike me pjesëmarrësen e publikut dhe politika mjedisore të qëndrueshme	Studimi, advokimi, ndërtimi i rrjeteve dhe kapaciteteve, komunikimi dhe puna me publikun	APC është një organizatë bamirëse jofitimprurëse e regjistruar në SHBA	Ndërkombëtare	Melville, Afrika e Jugut (zyra qendrore) dhe qytete të tjera në mbarë botën	1990– deri më sot

Koalicioni i shoqërisë civile Zëri i Popullit / Glas ljudstva	Reformat në media është një nga fushat e tyre të aktivitetit	Kërkesat parazgjedhore të shoqërisë civile për politika progresive, duke përfshirë reformat në media dhe më tej, monitorimi dhe advokimi paszgjedhor	Koalicioni i OJQ-ve dhe grupeve qytetare (më shumë se 100), individë mbështetës (disa mijëra), koordinim nga një ekip operativ prej 10-15 OJQ	Kombëtare	Slloveni	2021– deri më sot
Koalicioni për Lirinë e Medias / Koalicijazaslobodumedija	Reformat në media, statusi i gazetarëve	Advokimi dhe pjesëmarrja në zhvillimin e politikave mediatike	Gjashtë organizata, duke përfshirë shoqata të medias dhe gazetarësh	Kombëtare	Serbi	2021– deri më sot
Gazetarë të sigurtë Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Lirinë e Medias dhe Sigurinë e Gazetarëve	Siguria e gazetarëve, të drejtat e gazetarëve	Advokimi për të drejtat dhe sigurinë e gazetarëve përmes platformës online, bazë të dhënash të sulmeve dhe presioneve ndaj gazetarëve, njoftime për shtyp, raporte kërkimore, ngritje kapacitetesh	Organizatat e gazetarëve në: KRO, BOS, KOS, SER, MAQ, MAL (kjo e fundit është sindikatë), dhe një studiu në Shqipëri	Rajonale (Ballkani perëndimor)	Serbi	2015– deri më sot

Për sa i përket statusit të tyre ligjor dhe strukturës organizative, një koalicion mund të regjistrohet zyrtarisht në gjykatë si person juridik dhe të ketë një zyrë qendrore për koordinimin e punës, ose mund të funksionojë thjesht si nisëm të përbashkëta joformale pa u regjistruar si organizatë.

Shembull: KOALICIONI PËR LIRINË E MEDIAS (Serbi)

është një shembull pozitiv i një grupimi të dedikuar ndaj studimeve mbi median dhe advokimin. Koalicioni ka mbledhur së bashku gjashtë organizata të shoqërisë civile që angazhohen në monitorimin, analizimin dhe advokimin e politikave progresive në media. Një nga misionet e tyre përfshin angazhimin e përbashkët për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e gazetarëve, sigurinë e gazetarëve, shpenzimet publike në sektorin e medias dhe përmirësimin e ligjeve mbi median dhe kornizave vetërregulluese. Koalicioni është angazhuar në disa raste edhe me hartimin e ligjeve dhe strategjive të medias. Ndonëse disa nga sugjerimet e tyre janë mirëpritur dhe miratuar (kryesisht formulimi i strategjisë së medias), disa nga nismat dhe sugjerimet e tyre vazhdojnë të injorohen gjatë hartimit të projektligjeve mbi median, veçanërisht në ligjet mbi parandalimin e pronësisë së qeverisë mbi organet e medias dhe mbi përgjegjësinë e entit rregullator të medias që të marrë parasysh ankesat e qytetarëve dhe të kontrollojë nëse përmbajtja mediatike në fjalë ka shkelur rregulloret dhe legjislacionin mbi median.⁴⁰

40 Për më shumë lexo artikullin në faqen e internetit të rrjetit, tek: <https://koalicijazaslobodumedija.rs/2023/10/25/koalicija-za-slobodu-medija-i-crta-pokrenuli-peticiju-za-izmene-medijskih-zakona/>.

3.2.2. Organizata që kërkojnë reforma mediatike për garantimin e lirisë së shprehjes

Ka një mori organizatash nëpër botë që punojnë për të realizuar një sërë reformash në media, duke përfshirë parandalimin e përqendrimit të pronësisë së medias në pak duar dhe pluralizmin mediatik, ruajtjen dhe mbështetjen e mediave publike, pjesëmarrjen digjitale, mbrojtjen e privatësisë dhe kufizimin e mbikëqyrjes mbi qytetarët.

Tabela 7: **STUDIMI DHE ADVOKIMI PËR INTERESIN PUBLIK NË SEKTORIN E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT**

Emri	Fusha tematike	Lloji i projektit/aktivitetet	Organizatorët kryesorë	Shtrirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Një media më e mirë (Better media)	Reformat në media, pronësia e medias, vetërregullimi, media publike, transparencë, frenimi i gjigantëve të teknologjisë	Fushata për media të pavarura dhe çështje të lidhura me to	Koalicioni <i>Better media</i> , me anëtarësi të hapur	Kombëtare	Londër, Mbretëria e Bashkuar	2018–deri më sot
Koalicioni i Reformës në Media	Reformat në media, pronësia e medias, media qytetare, e ardhmja e gazetarisë	Fushata; peticione, studime	Një ekip kryesor prej pesë personash, akademikë, aktivistë dhe punonjës të mediave	Kombëtare	Londër, Mbretëria e Bashkuar	2011–deri më sot
Shtypi i lirë (Free Press -FP)	Internet i lirë dhe i hapur, llogaridhënie e medias dhe platformave mediatike, kontrolli mbi median, privatësia dhe mbikëqyrja	Fushata publike, studime dhe advokime	FP, me një staf prej 37 anëtarësh, duke përfshirë avokatë, aktivistë, studiues, mbledhës fondesh dhe administratorë	Kombëtare	Uashington, SHBA	2003–deri më sot
Të drejtat digjitale (Derechos digitales)	Liria e shprehjes Privatësia dhe të dhënat personale E drejta e autorit dhe aksesimi në njohuri	Studime, raporte, fushata, propozime për politika publike dhe advokim	OJQ Derechos digitales	Rajonale (Amerika Latine)	Santiago, Kili (zyra qendrore)	2005–deri më sot
Miqte e Transmetimeve Kanadeze (Friends of Canadian Broadcasting)	Diversiteti në media, lajme lokale, reforma e politikave mediatike, radio-televizioni publik	Fushata	OJQ Friends of Canadian Broadcasting	Kombëtare	Kanada	1985–deri më sot

Disa nga këto nisma u krijuan për t'iu kundërvënë një sërë tendencash shqetësuese. Për shembull, Fushata për Lirinë e Shtypit dhe Transmetimit në Mbretërinë e Bashkuar ishte një grup presioni që u krijua në vitin 1979 si reagim ndaj qëndrimit të njëanshëm të sektorit të medias në favor të partisë konservatore gjatë një periudhe kur qeveria po mbante qëndrime agresive kundër sindikatave. Këto organizata dhe projekte kanë punuar ndër vite për reformat në media. Disa prej tyre janë angazhuar në procese politikëbërëse dhe konsultohen rregullisht nga rregullatorët e medias dhe ligjvënës.

Shembull: RASTI I FREE PRESS (SHBA)

Free Press (Shtypi i Lirë) është një organizatë joqeveritare për advokimin e medias që ilustron potencialin e një organizate që pëmirësohet dhe fiton eksperiencë me kalimin e kohës dhe vë në praktikë ato njohuri të akumuluar. Shoqata u themelua në vitin 2003 me një staf shumë të vogël në numër, por tashmë është rritur si organizatë dhe ka një staf të konsiderueshëm prej më shumë se 35 punonjësish. Në disa raste shoqata ka arritur të ushtrojë ndikim mbi vendimarrjen në Uashington, si për shembull, mbi pronësinë e medias dhe neutralitetin në internet,⁴¹ financimin e radio-televizioneve publike dhe lajmet e rreme në media (McChesney 2009, 49). Free Press formon koalicione strategjike me grupe me ideologji të ndryshme, duke përfshirë për shembull Koalicionin e Krishterë dhe aktivistë të tjerë konservatorë, gjë që maksimalizon shanset për të pasur ndikim më të madh (Po aty, 52).

RASTI I MIQVE TË TRANSMETIMEVE KANADEZE (Kanada)

Miqtë e Transmetimeve Kanadeze, ose thjesht Friends, është një organizatë advokuese që monitoron zhvillimet në sektorin e radio-televizioneve kanadeze dhe mbështet forcimin e radio-televizioneve publike, shtimin e investimeve për përmbajtje mediatike kanadeze (duke përfshirë shërbimet e shpërndarjes të materialeve mediatike si Netflix, Amazon dhe Disney) dhe prodhimin e lajmeve lokale. Për shembull, ky koalicion kërkon të vendosen politika tatimore të favorshme për vendosjen e reklamave në mediat kanadeze (në krahasim me platformat globale në internet), dhe që Google dhe Facebook të paguajnë për materialet e publikuara nga organet mediatike kanadeze. Friends ka një staf bazë prej 10 personash, më shumë se 350,000 mbështetës në të gjithë vendin, dhe financohet nga donacione dhe fonde të mbledhura nga komuniteti. Kauza e tyre mbështetet mbi ndjenja nacionaliste, duke kërkuar dhe mbështetur politika mediatike që mundësojnë të dëgjohen zërat e kanadezëve, të ruhet kultura kombëtare dhe të publikohen lajme që kanë rëndësi për kanadezët.

41 Ndalimi i kompanive të telekomunikacionit që të vendosin se cilat faqe interneti transmetohen me shpejtësi më të madhe.

3.2.3. Aktivizëm dhe reagim kundër iniciativave politike reaksionare duke kërkuar ndryshime progresive të politikave

Aktivizmi mediatik përfshin si veprimtari ad hoc dhe ndërhyrje për të ndaluar propozime politike reaksionare, ashtu dhe advokim afatgjatë për zgjidhje dhe politika pozitive. Ky aktivizim mediatik mund të përfshijë protesta, letra, peticione, fushata mediatike dhe diskutime me përfaqësues të sektorit publik (Shiko tabelën 8 për disa shembuj).

Aktivizmi mediatik përfshin gjithashtu veprime dhe kërkesa ad hoc për të ndaluar propozimet e politikave të gabuara, si dhe advokim afatgjatë për zgjidhje politike pozitive.

Table 8: **SHEMBUJ TË AKTIVIZMIT KUNDËR/PËR NDRYSHIME POLITIKASH**

Emri	Fusha tematike	Lloji i projektit/aktivitetit	Organizatorët kryesorë	Shtirirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Media pa zgjedhje (Media without choice)	Tatimet mbi median, qëndrueshmëria, media e pavarur, liria e shtypit	Pezullimi i transmetimeve për 24 orë në shenjë proteste kundër taksave mbi të ardhurat nga reklamat që kërcënojnë kufizimin e lirisë së medias	24 media, duke përfshirë gazetën kryesore Gazeta Wyborcza dhe tabloidin Fakt	Kombëtare	Poloni	2 tetor 2021
Nisma kundër ndryshimeve në ligjin për median (Nuk ka faqe interneti. Për më shumë informacion klikoni këtu)	Rregullimi i medias, liria e medias	Lobim kundër ndryshimeve në Ligjin për Shërbimet e Mediave Audio dhe Audiovizive që synojnë të rregullojnë mediat online duke i dhënë kompetenca thuajse të ngjashme me gjykatën rregullatorit të mediave audiovizive	Gazetarë, BIRN Shqipëri, Këshilli Shqiptar i Medias, Fakteje, Citizens Channel, Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, etj.	Kombëtare (por aktivitetet u organizuan në Tiranë)	Shqipëri	2019–2022
Media kundër ndryshimeve të Ligjit mbi Median (Shiko për më shumë informacion disa raportin e Shoqatës së Gazetarëve)	Transparenca e financimit të medias, politikat e medias	Lobim kundër ndryshimeve të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizive, duke lejuar reklamë shtetërore në media	Bashkimi i Gazetarëve të Maqedonisë, Këshilli i Etikës në Media, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias, Instituti Maqedonas për Media	Kombëtare	Maqedonia e Veriut	2023–deri më sot
Reformimi i politikave mediatike	Gazetari cilësore, liria e medias, transparenca e financimit të medias	Mbështetja e reformave në media	BIRN BIRN, Internews-Kosova	Kombëtare Kombëtare	Serbi Kosovë	2011–2019 2007–2011 (e përfunduar)

Shembull: AKTIVIZËM KUNDËR NDRYSHIMEVE TË LIGJIT PËR SHËRBIMET MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE (Shqipëri)

Ka pasur përpjekje të vazhdueshme për të arritur rregullimin e përmbajtjes së mediave online në vendin tonë. Përpjekja e fundit në këtë drejtim ishte një paketë ndryshimesh në ligj për t'i dhënë entit rregullator kompetenca ekzekutive për të gjobitur dhe mbyllur mediat online në rast se qytetarët ankoheshin për përmbajtjen e tyre. Shumë organizata të shoqërisë civile i kundërshtuan këto ndryshime që mund të kufizonin lirinë e medias, duke qenë se pavarësia e entit rregullator nuk është e garantuar dhe masat ekzekutive ishin shumë të paqarta dhe kufizuese. Mediat dhe organizatat mediatike organizuan takime, hartuan deklarata dhe opinione kundër këtyre ndryshimeve, morën pjesë në seancë dëgjimore me komisionin parlamentar të medias dhe organizuan një protestë para parlamentit në dhjetor 2019 gjatë një seance plenare. Pavarësisht kësaj, ligji u miratua. Siqoqoftë, kjo veprimtari nga ana e shoqërisë civile solli mobilizimin e ndërkombëtarëve dhe presione ndërkombëtare për tërheqjen e ligjit. Në opinionin e publikuar në qershor 2020⁴² Komisioni i Venecias deklaroi se ligji “është i paqartë dhe ka të ngjarë që të ketë një efekt negativ duke shtypur diskutimin e lirë dhe fjalën politike.” Gjatë kësaj periudhe ligji nuk u zbatua por organizatat e shoqërisë civile vazhduan ta diskutojnë dhe kundërshtojnë në debate publike, tryeza diskutimi, emisione televizive, etj. Shfuqizimi i ligjit u njoftua në tetor 2022.

42 Tek: <https://www.coe.int/en/web/tirana/-/venice-commission-adopts-opinions-on-the-law-on-audio-visual-media-services-and-on-the-appointment-of-judges-to-the-constitutional-court>.

3.2.4. Aktivizmi mediatik me fokus në legjislacion: monitorim, mbështetje ligjore dhe advokim për të ndaluar keqpërdorimin e ligjit

Në mbarë botën po vihet re një tendencë në rritje e keqpërdorimit të ligjeve për të ushtruar presion ndaj mediave, gazetarëve dhe aktivistëve, që njihet me termin padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike (strategic lawsuit against public participation - SLAPP). Në këto raste kemi të bëjmë me keqpërdorim të ligjeve, duke hapur çështje gjyqësore për shpifje civile ose penale, por edhe për shkelje të ligjeve të tjera si prona intelektuale, privatësia dhe mbrojtja e të dhënave. Këto procese gjyqësore synojnë që të frikësojnë dhe t'i mbyllin gojën medias, si dhe të shterojnë burimet financiare dhe psikologjike të organizatave mediatike.⁴³ Këto padi kanë një efekt negativ në lidhje me ekspozimin e krimeve dhe abuzimeve, në shprehjen e opinionëve alternative dhe angazhimin publik.

Për këto arsye e konsiderojmë aktivizmin mediatik me fokus në legjislacion si një kategori më vete të aktivizmit mediatik që përfshin monitorimin dhe ekspozimin e keqpërdorimeve të tilla të ligjeve, mbështetjen ligjore për palët e paditura, si dhe advokim për ndryshime në legjislacion që të parandalojnë këto procese gjyqësore fiktive (shiko shembujt në Tabelën 9).

Aktivizmi mediatik i orientuar nga ligji përfshin monitorimin dhe ekspozimin e abuzimit me ligjin, mbështetjen ligjore për subjektet e prekura, dhe advokim në përgjithësi për rregullim më të mirë ligjor për të parandaluar paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPPs).

Tabela 9: **SHEMBUJ TË AKTIVIZMIT ME FOKUS NË LEGJISLACION**

Emri	Fusha tematike	Lloji i projektit/aktivitetit	Organizatorët kryesorë	Shtirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
AKTIVIZMI ANTI-SLAPP						
Ndaloni paditë abuzive! (peticion)	Liria e medias	Peticion për legjislacion të efektshëm anti-SLAPP në Evropë	CASE (Koalicioni anti-SLAPP në Evropë); OJQ nga Evropa	Ndërkombëtare (Evropë)	-	2023–deri më sot
Projekti Ura për lirinë e medias (Bridges for media freedom)	Liria e Medias Monitorim SLAPP	Monitorimi dhe dhënia e informacionit për çështje të mëdha gjyqësore që kanë të bëjnë me shkelje të lirisë së medias	OJQ - Blueprint for Free Speech (Projekti për Fjalën e Lirë)	Ndërkombëtare	-	2019–deri më sot
Monitorimi i proceseve gjyqësore ndaj gazetarëve	Liria e medias, llogaridhënia e medias	Monitorimi dhe ekspozimi i abuzimeve me ligjin në gjyqet kundër gazetarëve	Shoqata Studime mbi Median dhe Drejtësinë	Kombëtare	Turqi	2018–deri më sot

43 Parafrazim nga raporti i Parlamentit Evropian “Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP)”.

INICIATIVA TË TJERA TË AKTIVIZMIT LIGJOR

Article 19 (Artikulli 19)	Liria e shprehjes, E drejta për informim	Monitorimi i kërcënimeve ndaj shprehjes së lirë, lobimi për ligje progresive, hartimi i standardeve ligjore për shprehjen e lirë, aksesit në informacion, media publike, etj.	OJQ Article 19	Ndërkombëtare	Mbretëria e Bashkuar	1987–deri më sot
Rrjeti Ligjor për Mbrojtjen e Demokracisë (Legal Network for the Protection of Democracy)	Liria e medias dhe pavarësia e RTV publik	Përdorimi i njohurive dhe instrumenteve juridike, përfshi ligjin e ri për RTV publike (kërkohet depolitizimi i menaxhimit të RTV në një referendum mbi ligjin, dhe mbrojtje në Gjykatën Kushtetuese)	Rrjeti i 4 OJQ-ve (Qendra Ligjore, Amnesty International, Danes je novdan, Instituti Open) dhe një grup firmash ligjore dhe avokatësh që ofrojnë këshilla dhe shërbime juridike me/pa pagesë	Kombëtare	Slloveni	2020–deri më sot

Aktivizmi anti-SLAPP ka të bëjë kryesisht me kërkesat për pushimin e padive abuzive nga gjykatat, dhe mbron të drejtën për kompensimin e dëmeve dhe shpenzimeve të bëra nga pala e pandehur. Shoqatat e angazhuara në këtë lloj aktivizmi organizojnë edhe trajnime për gjyqësorin mbi SLAPP, regjistrojnë të gjitha rastet SLAPP, dhe kanë krijuar fonde të veçanta për mbështetje financiare për viktimat e SLAPP. Në vitin 2023, pati përpjekje advokimi në Bashkimin Evropian për miratimin e një direktive anti-SLAPP.⁴⁴ Aktivistët e fushës ligjore ofrojnë edhe analiza ligjore dhe propozojnë ndryshime ligjesh dhe politikash që lidhen me punën e radio-televizionit publik (RTV), pavarësinë e enteve rregullatore të medias, garancinë e aksesit në informacion publik, etj.

Aktivistët gjithashtu ofrojnë analiza ligjore dhe propozime politikash lidhur me ligje dhe politika të tjera, si ato që lidhen me transmetimet e shërbimit publik, pavarësinë e rregullatorëve të mediave, garancitë e aksesit në informacionin publik, etj.

44 Për më shumë: shiko letrën e hapur të koalicionit RAST publikuar në: <https://ipi.media/eu-anti-slapp-directive-cannot-be-a-missed-opportunity/>.

Shembull: RASTI I RRJETIT LIGJOR PËR MBROJTJEN E DEMOKRACISË LNPD (Slloveni)

Ky rrjet u krijua gjatë pandemisë COVID-19 dhe formimit të një qeverie të re të udhëhequr nga Partia Demokratike Sllovene, për të ofruar mbrojtje ligjore dhe për të kundërshtuar disa masa kufizuese të qeverisë, si kufizimi i të drejtës së lëvizjes, kufizimi i aksesit në informacion dhe pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse, si dhe për të ofruar mbështetje në raste sulmesh për organet e pavarura shtetërore, gjyqësorin, shoqërinë civile dhe protestuesit. LNPD u formua nga fundi i vitit 2020, kur Amnesty International Slloveni, Danes je novdan, PIC – Qendra Ligjore-Informative për OJQ-të dhe Instituti Open për Kulturën e Diversitetit – bashkuan forcat me mbështetjen dhe bashkëpunimin e disa zyrave të avokatisë, pedagogëve të fakultetit të drejtësisë dhe një numër të madh vullnetarësh. LNPD ofron këshillim ligjor, apelon vendime të institucioneve shtetërore, ndihmon në ngritjen e padive, bën kallëzime penale kundër zyrtarëve të qeverisë, organizon tryeza diskutimesh, etj. Disa ligje që kritikoheshin ashpër nga LNPD u shfuqizuan nga Gjykata Kushtetuese ose u kthyen për rishqyrtim në parlament – në këtë mënyrë rrjeti tregoi se sa potencial të madh mund të ketë një koalicion i solidarizuar në mbrojtje të shtetit të së drejtës.

Aktivistet mediatikë që merren me çështjet gjinore advokojnë, për shembull, për akses në platformat e komunikimit për gratë dhe anëtarët e komunitetit LGBTIQ, kundër presioneve me bazë gjinie, identiteti gjinor dhe seksual, dhe për përfaqësim më të mirë në përmbajtjen mediatike.

3.2.5. Aktivizmi mediatik mbi baza gjinore

Aktivistët e medias që merren me çështje gjinore në sektorin e medias dhe komunikimit angazhohen në një sërë fushash, si aksesit në platformat e komunikimit për femrat dhe anëtarët e komunitetit LGBTIQ, mbrojtja nga presionet dhe denigrimet ndaj personave që sulmohen për shkak të seksit, gjinisë dhe identitetit të tyre seksual, si dhe përfaqësimi i tyre në media. Nismat e aktivistëve të medias mundohen të promovojnë një mjedis më të mirë pune për gazetaret dhe një mjedis komunikimi më të sigurt dhe më të barabartë për grupet e cënueshme dhe pakicat politike.

Tabela 10: **SHEMBUJ TË AKTIVIZMIT GJINOR NË SEKTORIN E KOMUNIKIMIT**

Emri	Fusha tematike	Lloji i projektit/ aktivitetit	Organizatorët kryesorë	Shtrirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Koalicioni për Femrat në Gazetari (Coalition for Women in Journalism CFWJ)	Mbështetje për gazetaret femra dhe LGBTIQ	Advokimi për një mjedis profesional të sigurt dhe të mbarë, programe trajnimi, raporte dhe fushata në lidhje me pozitën e gazetarëve	OJQ CFWJ	Ndërkombëtare	Nju Jork, SHBA	2017–deri më sot
Rrjeti Feminist i Studimeve në Internet (Feminist Internet Research Network FIRN)	Aksesi, Kompanitë e mbledhjes të të dhënave, impakti mbi grupet e cënueshme, dhuna në internet mbi baza gjinore barazia gjinore në ekonominë digjitale	Studime, advokim, shkëmbime	Shoqata për Komunikime progresive (Association for Progressive Communications)	Ndërkombëtare	Melville, Australi (zyra qendrore), qendra anembanë botës	2018–(rreth) 2021
Projekti Global për Monitorimin e Medias (The Global Media Monitoring Project GMMP)	Përfaqësimi i femrave në mediat e lajmeve	Monitorim i përmbajtjes në media, zhvillohet çdo pesë vjet	Koordinohet nga Organizata Botërore për Komunikim të Krishterë (World Association for Christian Communication WACC); aktivistë vullnetarë, studiues dhe shoqata në 114 vende	Ndërkombëtare	Zyrat qendrore të WACC në Kanada dhe Mbretërinë e Bashkuar	1995–deri më sot
Monitorimi i medias	Llogaridhënie e medias, diversiteti	Monitorimi dhe publikimi i raporteve mbi përmbajtjen mediatike rreth identiteteve LGBTI	Shoqata kulturore homoseksuale dhe lezbike për studim dhe solidaritet (Gay and Lesbian Cultural Research and Solidarity Association KAOS GL)	Kombëtare	Turqi	2009–deri më sot

Shembull: [RRJETI FEMINIST I STUDIMEVE NË INTERNET FIRN](#) (Australi)
 FIRN është e specializuar në studime që bazohen në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të nxitur ndryshime në politika dhe ligje, dhe për të ndezur debatin rreth të drejtave në internet. Objektivi i rrjetit është që të merren parasysh në diskutimet dhe vendimmarrjen mbi politikat rreth internetit nevojat e grave dhe personave me orientim të ndryshëm gjinor. Rrjeti trajton çështje si dhuna mbi baza gjinore në internet, aksesit në internet për gratë në vende në zhvillim, pjesëmarrja e publikut në projektimin dhe konceptimin e telefonave celularë (smartphone), margjinalizimi i grupeve të cënueshme në ekonominë e internetit, dhe shumë tema të tjera. FIRN financohet nga Qendra Kërkimore për Zhvillimin e Internetit (Internet Development Research Centre IDRC).

3.2.6. Advokim për reklama etike dhe eliminimi i të ardhurave për praktika joetike në media

Aktivistet e medias angazhohen në monitorimin, zbulimin dhe luftën kundër shkeljeve në sektorin e reklamave dhe përdorimit të fondeve të reklamave për të mbështetur platforma që publikojnë përmbajtje të dëmshme për publikun, si dezinformimi, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimit, duke mos respektuar mekanizmat e vetërregullimit dhe standardet gazetareske të drejtësisë dhe saktësisë. Këto platforma mbështeten tek të ardhurat nga reklamat, si nga burime komerciale ashtu edhe nga organe qeveritare. Aktivizmi mediatik angazhohet në fushata që të ndërgjegjësojë të dy llojet e reklamuesve që të marrin në konsideratë vlerën ose dëmin e shkaktuar ndaj interesit publik nga organet e medias kur vendosin se kujt t'i japin reklama, si për shembull të mos i japin para urrejtjes, diskriminimit dhe dezinformimit në media (Shiko disa shembuj në Tabelën 11).

Aktivistet mediatikë punojnë për monitorimin, ekspozimin dhe kundërshtimin e abuzimeve të fushatave dhe praktikave reklamuese, si dhe bëjnë fushata për të demonetizuar urrejtjen, diskriminimin dhe dezinformimin në media.

Tabela 11: **SHEMBUJ TË AKTIVIZMIT PËR REKLAMA ETIKE DHE ELIMINIM TË ARDHURASH PËR PRAKTIKA JOETIKE NË MEDIA**

Emri	Fusha tematike	Lloji i projektit/aktivitetit	Organizatorët kryesorë	Shtrirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
#KeinGeldFürRechts (Asnjë grosh për të djathtën)	Liria e medias Financimi i medias	Fushata online (blog, tweet dhe hashtag)	Gerald Hensel, person privat	Kombëtare, me ndikim ndërkombëtar	Gjermani	2016–2017
Državljan D/ (Qytetari D)	Edukimi mbi median dhe informacionin, të drejtat digjitale, kundër fondeve të qeverisë për urrejtjen në media	Monitorimi i reklamave të institucioneve dhe kompanive publike në mediat e urrejtjes, podcast	OJQ Instituti Qytetari D (Domen Saviç)	Kombëtare, bashkëpunim me partnerë nga Evropa jug-lindore dhe BE	Sloveni	2015–deri më sot

Këto fushata nxisin diskutimin publik mbi përmbajtjen e dëmshme mediatike dhe kërkojnë nga reklamuesit që të sillen në mënyrë më etike kur përzgjedhin mediat për reklamat e tyre. Më konkretisht, nga reklamuesit kërkohet që të mos vendosin reklama në media që promovojnë urrejtjen, përhapin dezinformata ose promovojnë ideologji të ekstremit të djathtë.

Shembull: RASTI I ASNJË GROSH PËR TË DJATHTËN (Gjermani)

(për më shumë kliko [këtu](#)).

Gerald Hensen, menaxher në një kompani reklamash, ndërmorri një iniciativë në vitet 2016-2017 që u bë shembull frymëzimi, dhe tregon se si një person i thjeshtë mund të ndezë një debat që çon në ndryshime të rëndësishme. Mesazhi hashtag #KeinGeldFürRechts (Asnjë grosh për të djathtën) u bën thirrje reklamuesve që të mos vendosin reklama në faqet e internetit të krahut të djathtë të mbushur me dezinformata. Ka të dhëna nga disa burime se faqet e internetit të krahut të djathtë që u vunë në shënjestër nga Hensen raportuan rënie të të ardhurave menjëherë pasi u bë viral mesazhi në Twitter (shiko postimin e Institutit Goethe). Për më tepër, jehona e kësaj iniciative dhe diskutimi që pasoi bëri që disa kompani të mëdha në SHBA të njoftonin në vitin 2017 se “nuk do të vendosim më reklama në programe në YouTube, pasi kjo platformë nuk mund të sigurojë dot që videot e reklamave që luhen automatikisht nuk do të shoqërojnë video me përmbajtje raciste, seksiste ose video të tjera me përmbajtje joetike.” Disa nga masat e marra në këtë drejtim janë hartimi i “listave të zeza” në sektorin e reklamimit, dhe mekanizma kontrolli, si monitorimi i vendosjes së reklamave me video. Ka disa vite që këto masa janë diskutuar dhe janë zbatuar në praktikë nën siglën “Siguria dhe përshtatshmëria e markës” (Baumgarth et al 2021, 19).

Në Slloveni, **Domen Savič dhe OJQ-ja që drejton, Instituti Qytetari D** kanë vite që kanë ndërmarrë një fushatë të ngjashme, duke përfshirë monitorimin e reklamave të institucioneve dhe kompanive publike në media që publikojnë materiale me gjuhë urrejtje, transmetojnë një emision radiofonik në internet, dhe bëjnë fushata në media. Fushata ka nxitur edhe diskutime parlamentare në lidhje me praktikën korruptive të vendosjes së reklamave nga kompani publike.

3.2.7. Verifikimi i fakteve

Platformat e verifikimit të fakteve, duke përfshirë edhe ato që funksionojnë në rajonin e Evropës juglindore,⁴⁵ japin kontributin e tyre për të vënë në pah problemin e dezinformimit, në promovimin e saktësisë dhe vërtetësisë në komunikimin mediatik dhe publik, si dhe në edukimin mediatik të qytetarëve. Këto platforma bashkëpunojnë ngushtë me njëra-tjetrën dhe kjo i ndihmon që të monitorojnë dhe t'i kundërvihen shpërndarjes ndërkufitare të lajmeve të rreme. Puna e tyre forcon rezistencën e publikut ndaj dezinformimit.

Tabela 12: **SHEMBUJ TË PLATFORMAVE TË VERIFIKIMIT TË FAKTEVE**

Emri	Fusha tematike	Lloji i projektit/aktivitetit	Organizatorët kryesorë	Shtrirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Qendra për Ekspertim Digjital (The Digital Forensic Centre)	Përgjegjësia e medias, verifikimi i fakteve	Angazhimi në verifikim e fakteve	Atlantic Council	Kombëtare	Mali i Zi	2020–deri më sot
Fake News Tragač (tracer)	Përgjegjësia e medias, verifikimi i fakteve, lajmet e rreme në media	Monitorimi i raportimit në media dhe raportimi mbi përmbytjet që përfshijnë dezinformim dhe propagandë	Fakulteti i gazetarisë në Novi Sad	Kombëtare	Serbi	2017–deri më sot
raskrinkavanje.me	Përgjegjësia e medias, verifikimi i fakteve	Angazhim në verifikimin e fakteve	Qendra për Tranzicion Demokratik (Center for Democratic Transition)	Kombëtare	Mali i Zi	2018–2023 (në vazhdim)
Faktoje	Verifikimi i fakteve, transparenca e institucioneve qeveritare	Angazhim në verifikimin e fakteve	Faktoje	Kombëtare	Shqipëri	2018–deri më sot
Raskrinkavanje (Demaskim)	Lufta kundër dezinformimit, propagandës dhe informacioneve mashtruese, verifikimi i fakteve	Platformë për verifikimin e fakteve	OJQ Zasto ne (Pse jo)	Kombëtare	Sarajevë, Bosnjë Hercegovinë	2017–deri më sot

Këto faqe interneti vizitohen gjithnjë e më shumë nga publiku dhe raportet e tyre publikohen edhe nga mediat kryesore.

45 Këtu përfshihen edhe këto platforma: Raskrinkavanje.ba (Bos), Raskrinkavanje.me (Mal), Faktograf.hr (Kro), Raskrinkavanje.rs (Ser), FakeNewsTragač (Ser), Razkrinkavanje.si (Sll) and F2N2.mk (Maq).

Shembull: [RASTI I PLATFORMËS DEMASKIM \(RASKRINKAVANJE\)](#)

(Bosnjë Hercegovinë)

Platforma e verifikimit të fakteve Raskrinkavanje u krijua nga Shoqata Qytetare Zašto ne (*Pse jo*) në vitin 2017. Është një platformë që verifikon artikuj në mediat online dhe rrjetet sociale për të demaskuar dezinformata dhe lajme të rreme bazuar në ankesat e lexuesve dhe përhapjen virale. Në vitin 2020, platforma filloi të bashkëpunojë me Facebook (Programi i Verifikimit të Fakteve të Palëve të Treta)⁴⁶ për të luftuar dezinformimin. Pasi verifikuesit e fakteve zbulojnë lajme të rreme dhe përmbajtje mediatike false, Facebook e klasifikon atë material si problematik dhe merr masa për të reduktuar shpërndarjen e mëtejshme tek përdoruesit e tjerë, dhe paralajmëron faqen kundër shpërndarjes të informacionit të pasaktë. Në këtë mënyrë reduktohet disi përmbajtja problematike dhe niveli i shpërndarjes të dezinformatave, duke ulur ndjeshëm fitimet e faqeve abuzive nga reklamat. Nëse postimi korrigjohet, Facebook i heq sanksionet ndaj faqes.

46 Për më shumë mbi këtë projekt, shikoni: <https://www.facebook.com/formedia/mjp/programs/third-party-fact-checking>.

3.2.8. Aktivizëm për llogaridhënie në media

Aktivizmi mediatik përfshin edhe thirrje për më shumë përgjegjësi dhe llogaridhënie për përmbajtjen që publikohet në media dhe platformat jo-gazetareske. Këta aktivistë monitorojnë dhe zbulojnë përmbajtje të dëmshme mediatike dhe kërkojnë një (vetë)rregullim më të mirë të medias.

Tabela 13: **SHEMBUJ TË AKTIVIZMIT PËR LLOGARIDHËNIE NË MEDIA**

Emri	Fusha tematike	Lloji i projektit/ aktivitetit	Organizatorët kryesorë	Shtirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Hacked Off (Hakerim)	Liria e medias Përgjegjësia e medias	Fushata për reformimin e legjislacionit mbi median, duke përfshirë masat ndëshkuese, ndërmjetësimin, si dhe publikimin e përgënjeshtimeve dhe kërkimit falje	Ekipi kryesor përfshin nëntë gazetarë, juristë, pedagogë dhe një viktimë të hakerimit të telefonit	Kombëtare	Londër, Mbretëria e Bashkuar	2011–deri më sot
FAIR (Ndershmëri)	Përgjegjësia e medias, raportim i pavarur	Analizimi i praktikave mediatike që lënë në plan të dytë interesin publik, pasqyrimi i temave të injoruara, etj	OJQ Ndërshmëri dhe Saktësi (Fairness and accuracy), staf me gazetarë dhe pedagogë	Kombëtare	Nju Jork, SHBA	1986–deri më sot
Monitorim i medias për gjuhën e urrejtjes	Gjuha e urrejtjes, përgjegjësia e medias	Zhvillimi dhe mbështetja e studimeve	Fondacioni Hrant Dink (Projekti Asulis)	Kombëtare	Turqi	2009–deri më sot
Analizimi i gjuhës së urrejtjes	Përgjegjësia e medias, gjuha e urrejtjes, gjuha diskriminuese, mohimi i gjenocidit	Bazë të dhënash	BIRN Bosnjë Hercegovinë	Kombëtare	Sarajevë, Bosnjë Hercegovinë	2021–deri më sot

Shembull: RASTI I HACKED OFF (HAKERIM) (Mbretëria e Bashkuar)

Hack off është një fushatë që kërkon rregullimin e sektorit të shtypit në MB. U krijua si reagim ndaj skandalit të hakerimit në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2011, kur u zbulua se redaksia e gazetës News of the World dhe gazeta të tjera britanike në pronësi të Rupert Murdoch ishin përfshirë në përgjime dhe hakerime telefonike, korrupsione të policëve dhe sjellje të pahijshme gjatë raportimit dhe shkrimit të artikujve.⁴⁷

47 Ndonëse nuk biem dakord që rregullimi me legjislacion i sektorit të shtypit është zgjidhja më e mirë, këtu po përmendim Hacked off vetëm si një shembull të advokimit për llogaridhënie dhe (vetë)rregullimin në media.

3.2.9. Iniciativa të tjera për monitorimin dhe mbikëqyrjen e mediave

Aktivizmi mediatik merret edhe me mbikëqyrjen dhe monitorimin e sektorit të medias dhe komunikimit duke u fokusuar në monitorimin e përmbajtjes (duke përfshirë gjuhën e urrejtjes dhe dezinformimin), monitorimin e mjedisit mediatik, si financimi dhe pronësia e medias, etj. Në Tabelën 14 kemi paraqitur një listë me shembuj projektesh dhe fushatash për mbikëqyrjen e medias.

Tabela 14: **SHEMBUJ TË INICIATIVAVE PËR MONITORIMIN DHE MBIKËQYRJEN E MEDIAS**

Emri	Fusha tematike	Lloji i projektit/ aktivitetit	Organizatorët kryesorë	Shtrirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Monitorimi i medias Mérték	Liria e medias, legjislacioni mbi median, tregu i medias, përmbajtja mediatike	Analiza mbi çështje të ndryshme të lidhura me median (si financimi nga qeveria, pavarësia e entit rregullatorit të medias etj)	Gjashtë ekspertë, staf dhe bashkëpunëtorë të jashtëm	Kombëtare, por disa nga analizat merren me vende të Evropës qendrore dhe më gjerë	Hungari	2011–deri më sot
Real 411	Lufta kundër dezinformimit, gjuhës së urrejtjes, nxitjes së krimit dhe ngacmimit	Monitorimi i punës kërkimore dhe analiza, 2) Advokim, çështje gjyqësore dhe lobim, 3) Angazhimi i komunitetit dhe audiencës, 4) Përmirësimi i aftësive të medias dhe publikut	OJQ Monitorimi i Medias në Afrikë (Media Monitoring Africa MMA) dhe Forumi Kombëtar Afrikan i Redaktorëve (African National Editors Forum SANEF)	Rajonale	Johanesburg, Afrika e Jugut	2019–deri më sot
Media.ba	Llogaridhënia mediatike, pavarësia e medias, gazetaria cilësore	Faqe interneti që publikon lajme, analiza, studime dhe materiale edukative mbi median dhe komunikimin në Bosnjë Hercegovinë dhe më gjerë	Qendra e medias Sarajevë (Mediacentar Sarajevo)	Kombëtare	Sarajevë, Bosnjë Hercegovinë	1995–deri më sot
Raporte nga Monitorimi i medias (BIA Media monitoring reports)	Liria e medias, llogaridhënia në media	Monitorimi dhe publikimi i raporteve vjetore dhe tremujore	Fondacioni i komunikimit IPS/ Bianet (Erol Önderoğlu)	Kombëtare (lokale, rajonale, kombëtare)	Turqi	2001–deri më sot

Shembull: **RAPORTE MONITORIMI TË MEDIAS TË BIA-S NGA FONDACIONI I KOMUNIKIMIT IPS** (Turqi)

Raportet tremujore dhe vjetore të monitorimit të BIA-s kryejnë një mision të rëndësishëm duke identifikuar shkeljet e lirisë së medias në Turqi, duke përfshirë ndjekje penale arbitrare me akuza për shkelje të Kodit Penal të Turqisë dhe ligjit antiterror, dënime me burg, gjoha administrative, dhunë fizike nga forcat e rendit, akuza për “pjesëmarrje në organizatë terroriste,” seanca dëgjimore, ndryshime legjislative, fushata dhe raporte kombëtare dhe ndërkombëtare. Raportimi dhe mbledhja e të dhënave kryhet nga Erol Önderoğlu, përfaqësues i shoqatës Reporterë pa Kufi (RSF), i cili ndjek lajmet, kontakton me OJQ, avokatë, shoqata gazetarësh, dhe gazeta për përpilimin e këtyre raporteve. Së shpejti, këto raporte do të publikohen nga Baza e të Dhënave të Monitorimit të Medias (*Media Monitoring Database*), ku përmbledhen informacione që mund të kërkohen në atë faqe dhe të përdoren nga gazetarë, akademikë, avokatë, aktivistë, komuniteti ndërkombëtar dhe publiku i gjerë. Raportet e monitorimit të medias nga IPS janë burim i rëndësishëm informacioni për organizatat ndërkombëtare, ndërqeveritare dhe kombëtare, që ushtrojnë presion mbi autoritetet qeveritare kur kemi të bëjmë me ndëshkime ligjore ndaj gazetarëve, shkrimtarëve, botuesve dhe akademikëve.

Aktivizmi mediatik përfshin edhe përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve që mund të forcojnë gazetarinë e interesit publik, si dhe monitorimin dhe advokimin për interesin publik në sektorin e medias dhe komunikimit.

3.3. RRRITJA E KAPACITETEVE TË MEDIAS, GAZETARËVE DHE QYTETARËVE

Së fundmi, aktivizmi mediatik përfshin edhe përpjekje për rritjen e kapaciteteve për të ndihmuar mediat që të angazhohen në gazetari që i shërben interesit publik, si dhe monitorimin dhe advokimin e interesit publik në sektorin e medias dhe komunikimit. Disa shembuj të tillë janë renditur në tabelat 15 dhe 16.

Table 15: **EXAMPLES OF CAPACITY-BUILDING INITIATIVES FOR JOURNALISTS AND MEDIA**

Emri	Fusha tematike	Lloji i projektit/ platformës/aktivitetit	Organizatorët kryesorë	Shtrirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Seminare për sigurinë digjitale	Edukim mediatik Siguria digjitale Aksesi në informacion	Takime dhe seminare për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, gazetarët dhe aktivistët	Rrjeti Tajlandez i Qytetarëve Digjitalë (Thai Netizen Network)	Kombëtare	Tajlandë	2008 (afërsisht) – deri më sot
Zëra të Lirë (Slobodni glasovi)	Trajnimi i gazetarëve	Programe trajnimi për gazetarët	Qendra e medias Sarajevë (Mediacentar Sarajevo)	Kombëtare	Sarajevë, Bosnjë Hercegovinë	2016– deri më sot
Gazetaret kundër dhunës ndaj grave	Cilësia e medias, Raportimi mbi gratë e rrezikuara nga dhuna	Sensibilizimi i gazetarëve	UNDP dhe Fondi B92	Kombëtare	Serbi	2017– deri më sot

Tabela 16: **SHEMBUJ TË INICIATIVAVE PËR RRIJTEN E KAPACITETEVE PËR QYTETARËT (PËR EDUKIMIN DHE AKTIVIZMIN MEDIATIK)**

Emri	Fusha tematike	Lloji i projektit/ platformës/aktivitetit	Organizatorët kryesorë	Shtirja e aktivitetit	Zona gjeografike	Kohëzgjatja
Edukimi mediatik	Edukimi mediatik	Iniciativë për të futur edukimin mediatik në kurrikulat arsimore	Instituti Shqiptar i Medias në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, dhe në partneritet me universitete publike dhe private	Kombëtare	Shqipëri	2020–2024 (vazhdon)
Edukimi mediatik në kampe rinore	Edukimi mbi median dhe informacionin	Kampe arsimore	Qendra e medias Sarajevë	Kombëtare	Sarajevë, Bosnjë Hercegovinë	2018–deri më sot
Edukimi mediatik	Edukimi mediatik	Krijimi i praktikave të edukimit mediatik, aktivitete kërkimore, kuize të edukimit mediatik, panele diskutimi	Fakulteti i gazetarisë në Novi Sad	Kombëtare	Serbi	2006–deri më sot
Edukimi mediatik	Edukimi mediatik	Bashkëpunim midis qeverisë dhe organizatave jo-qeveritare, e mbështetur nga IREX, për të futur EMI në shkolla	IREX, Instituti Maqedonas për Media, Instituti për Studime të Komunikimit dhe Forumi Arsimor Rinor, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencinë për Zhvillim	Kombëtare	Maqedonia e Veriut	2021–2025
Projekti i gazetarëve të rinj	Edukimi mediatik, Trajnim gazetarie, verifikim faktesh	Edukimi mediatik për të rinj, dhënia e eksperiencës mediatike, angazhimi në verifikimin e fakteve	UNICEF Mali i Zi UNICEF, Instituti Shqiptar i Medias, Faktoje, ACQJ, Citizens Channel, Projekti Zëra Globalë (Global Voices)	Kombëtare	Mali i Zi/ Shqipëri	2018–deri më sot 2000–deri më sot (projekt i rinovuar disa herë)
Edukimi mediatik	Edukimi mediatik	Iniciativa për futjen e edukimit mediatik në arsim	Instituti Malazez i Medias	Kombëtare	Mali i Zi	2019–deri më sot

Shembull: PREZANTIMI I EDUKIMIT MEDIATIK (në Malin e Zi dhe më gjerë)

Edukimi mediatic është tashmë pjesë e sistemit arsimor në Malin e Zi si lëndë me zgjedhje në gjimnaze (nxënësit e gjimnazit – shkollë e mesme elitare përgatitore për universitet - përbëjnë vetëm 30 për qind të numrit të nxënësve të shkollave të mesme në atë vend) por jo në shkollat profesionale dhe arsimin fillor. Për këtë arsye Instituti Malazez i Medias, në bashkëpunim me ekspertë të edukimit mediatic dhe partnerë të tjerë nga shoqëria civile dhe arsimit, ka disa vite që kërkon futjen e edukimit mediatic në të gjitha shkollat dhe nivelet. Shoqëria civile ndërmori një fushatë intensive nga viti 2018 deri në vitin 2022, dhe të dhënat zyrtare nga Ministria e Arsimit tregojnë një interes në rritje nga ana e nxënësve të shkollave të mesme për edukimin mbi median dhe informacionin si dhe rritjen e interesit për të mirën e përgjithshme. Në vitin 2022, autoritetet vendosën të fusin edukimin mediatic si lëndë me zgjedhje për nxënësit e të gjitha shkollave fillore në Mal të Zi. Tekstet mësimore për nxënësit janë hartuar nga Instituti Malazez i Medias në bashkëpunim me ekspertë të jashtëm në vitin 2023. Agjencia për Arsim, Agjencia për Media Elektronike dhe Instituti Malazez i Medias kanë nisur një fushatë për promovimin e kësaj lënde dhe trajnimin e mësuesve të shkollave fillore. Kjo është një nga iniciativat më të suksesshme të Institutit të Medias në Mal të Zi, partnerëve të tij nga institucionet shtetërore dhe ekspertëve të edukimit mediatic. Ky rast ilustron sinergjinë e iniciativës dhe bashkëpunimit të ndërsjellë të institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertëve të edukimit mediatic.

Nisma të ngjashme janë ndërmarrë edhe në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, dhe në Serbi, duke treguar se ekziston një vullnet i konsiderueshëm politik në rajon për të punuar në këtë drejtim. Është mirë që të mundësohet shkëmbimi i përvojave nga vendet e Evropës juglindore mbi këto iniciativa.

3.4. ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE PËR LIRINË E MEDIAS DHE ZHVILLIMIN MEDIATIK, RRJETE DHE INICIATIVA DONATORËSH

Së fundmi, nuk mund të lihen pa përmendur **organizatat dhe rrjetet ndërkombëtare për zhvillimin dhe mbrojtjen e mediave dhe gazetarëve**, si Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve (Committee to Protect Journalists), Reporterët pa Kufij (Reporters Without Borders), Rrjeti Global i Organizatave Kombëtare për Zhvillimin e Medias (Global Network of National Organisations for Media Development GFMD) dhe IFEX,⁴⁸ që paraqesin një front të veçantë në luftën për aktivizëm të vazhdueshëm mediatik si nga rrjete ashtu edhe nga organizata individuale.⁴⁹ Nëpërmjet fushatave globale mediatike ato përdorin kapacitetet dhe ndikimin e tyre për të paralajmëruar dhe dënuar shtypjen dhe dhunën ndaj gazetarëve dhe organeve të medias, dhe për t'u angazhuar drejtpërdrejt me qeveritë për të kërkuar liri dhe të drejta për gazetarët. Organizatat e zhvillimit të medias ofrojnë edhe mbështetje për mediat e pavarura, duke përfshirë këtu financimin, zhvillimin e modeleve të mbledhjes së fondeve, mbështetjen e zhvillimit të mediave publike, lobimin për financim dhe politika më të mira për gazetarinë, si dhe ofrimin e bursave dhe programeve të trajnimit.

Ka edhe **fonde ndërkombëtare**, si Fondi Ndërkombëtar i Zhvillimit të Medias (International Media Development Fund IMDF), Fondi Ndërkombëtar për Gazetarët (International Fund for Journalists) dhe organizata të tjera të dedikuara për zhvillimin e medias dhe mbështetjen e aktivizmit mediatik. Krijimi i *Fondit Ndërkombëtar për Mediat me Interes Publik* (International Fund for Public Interest Media) në vitin 2021, nga ministri dhe agjenci qeveritare të SHBA-së dhe vendeve të tjera (si Danimarka, Zvicra, Suedia, Tajvani, Zelanda e Re, Estonia, etj.) së bashku me financues dhe donatorëve privatë (Google, Fondacioni Ford, Craig Newmark Philanthropies, etj.) erdhi nga nevoja për ndihmë afatgjatë dhe më thelbësore për median, veçanërisht tani që kemi të bëjmë në një klimë armiqësore politike dhe mbështetje të kufizuar nga publiku.⁵⁰

48 Përveç deklaratave për median dhe advokimit RSF ndërmerr edhe akte demonstrative simbolike, si ndërhyrja në ceremoninë e nderjes së flakës në lojrat olimpike 2008 duke shpalosur një pankartë të madhe me pranga të ndërlidhura që imitonin flamurin olimpiq me rrahë.

49 Një pëpëllim i listës së plotë të organizatave të zhvillimit të medias nuk është objektivi i këtij raporti

50 Deri më sot është e paqartë nëse Fondi do të mbledhë më shumë para për median, ashtu siç ishte planifikuar, apo nëse thjesht do të shpërndajë fondet ekzistuese. Fillimisht të dhënat tregojnë se Fondi ka arritur të mbledhë vetëm gjysmën e shumës prej 100 milion dollarëve që mendohet se janë të nevojshme për të siguruar vazhdueshmëri dhe qëndrueshmëri (Simon 2023, 28).

IV.

DISKUTIME PËRMBYLLËSE

Aktivizmi mediatik ka arritur rezultate të jashtëzakonshme, si parandalimi i miratimit të ligjeve reaksionare për median, zbatimimi i ligjit kundër zyrtarëve të korruptuar, punë kërkimore dhe informimi i shoqërisë mbi çështje me interes publik lidhur me median dhe komunikimin, fuqizimi i mediave dhe gazetarëve për mbrojtjen dhe vazhdueshmërinë e gazetarisë së orientuar nga interesi publik, ofrimi i edukimit mediatik për publikun, rritja e rezistencës ndaj praktikave të dëmshme mediatike, iniciativat për të kërkuar liri dhe llogaridhënie në media, si dhe advokimi për reforma në media, për ndryshime në politika dhe praktika mediatike. Nga ana tjetër, edhe vetë ekzistenca e aktivistëve të medias është një sukses në vetvete, pasi sjell zëra alternativë në debatin publik mbi median, duke iu kundërvënë fenomenit gjithnjë e më shqetësues të kapjes së medias nga interesa politike dhe ekonomike.

Në vendet e përfshira në projektin Media Jonë, nismat e aktivizmit mediatik ndërmerren kryesisht nga organizata jo-qeveritare dhe shoqata gazetarësh, por nganjëherë udhëhiqen edhe nga media alternative, studiues dhe grupe të tjera aktive në fushën e medias. Për pasojë, nismat e aktivizmit mediatik shpesh varen nga financimi i lidhur me projekte individuale afatshkurtra dhe nga axhendat institucionale. Sidoqoftë, shumë nga iniciativat e advokimit të politikave mediatike janë ndërmarrë mbi baza vullnetare, duke përfshirë nisma të momentit që i janë kundërvënë propozimeve legjislativ reaksionare, por ka pasur edhe nisma afatgjata, si koalicionet për promovimin e edukimit mediatik. Në këto nisma janë përfshirë individë nga fusha nga më të ndryshmet, si aktivistë të shoqërisë civile, arsimtarë, gazetarë, studiues, madje herë pas here është ofruar edhe ndihmë ligjore pa pagesë nga avokatë; studio grafike dhe agjenci të ndryshme kanë punuar falas për realizimin e materialeve vizive, pankartave dhe sloganeve; shtypshkronja nuk kanë marrë para për shtypjen e posterave me slogane të fushatës; njerëz të kulturës dhe artistë (aktivizëm) duke përfshirë aktorë, piktorë, muzikantë, dhe të tjerë në sektorin e kulturës kanë vënë talentin ose mjetet e tyre në dispozicion të fushatave për media dhe demokraci.

Me prezantimin e shembujve dhe rasteve të aktivizmit mediatik synojmë të ofrojmë sa më shumë informacion për aktivizmin mediatik dhe nismat e edukimit mediatik në të ardhmen brenda dhe jashtë projektit rajonal "Media jonë".

Tabela 17: **LLOJET E AKTIVIZMIT MEDIATIK**

<p>Platformat alternative, publikojnë informacione me vlerë mbi tema që nuk raportohen sa duhet në media</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Platforma të gazetarisë qytetare b. Blogje (duke përfshirë blogjet mbi median dhe komunikimin, si dhe blogje mbi çështje të tjera me rëndësi publike që nuk raportohen sa duhet në media) c. Mediat e komunitetit d. Mediat e pavarura e. Projekte, qendra dhe rrjete rajonale / ndërkombëtare të gazetarisë investigative f. Iniciativa për të mbështetur platforma alternative (mbledhje fondesh, mbështetje logjistike, etj)
<p>Platforma alternative që ofrojnë shërbime interneti</p> <p>publikimi i faqeve në internet, posta elektronike në internet, platforma komuniteti në internet, shërbimi i blogut (publikimi dhe arkiva e të dhënave të blogut)</p>
<p>Studime, fushata dhe advokim për reformat në media</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Koalicione për reformat në media b. Iniciativa për një gamë të gjerë reformash në media (duke përfshirë punë kërkimore dhe advokim) c. Reagime kundër propozimit të politikave reaksionare, dhe kërkesa për ndryshime progresive të politikave d. Aktivizmi mediatik i orientuar drejt legjislacionit: monitorim, mbështetje ligjore dhe advokim për të parandaluar keqpërdorimin e ligjeve e. Aktivizmi mediatik mbi baza gjinore (duke përfshirë edhe përfaqësimin e femrave dhe komunitetit LGBTIQ në komunikim, si dhe çështje të aksesit në media dhe teknologji) f. Aktivizëm për një sistem reklamash etik dhe reduktimin e të ardhurave për praktika joetike në media (demonetizim) g. Verifikimi i fakteve h. Aktivizëm për forcimin e llogaridhënies së medias i. Iniciativa të tjera për monitorimin dhe mbikëqyrjen e mediave (duke përfshirë monitorimin e lirisë së shprehjes, monitorimin e përmbajtjes në media, reklammat, etj.)
<p>Rritja e kapaciteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Iniciativa që synojnë rritjen e kapaciteteve të medias dhe gazetarëve (trajnime, studime në vende të tjera, mbështetje teknike dhe logjistike, etj). b. Iniciativa që synojnë rritjen e kapaciteteve të qytetarëve (trajnime për edukimin mbi median dhe informacionin, verifikimi i fakteve, monitorimi i praktikave të dëmshme në media, etj).

Nga ana tjetër, për të pasur një jehonë dhe ndikim sa më të madh kulturor dhe politik aktivizmi mediatik duhet të tërheqë grupe të ndryshme qytetare, si prindër, bibliotekarë, të rinj, etj. Mobilizimi qytetar në të ardhmen do të varet nga aftësia e aktivistëve të medias për t’iu përgjigjur shqetësimeve të përditshme të masave të gjera, dhe për të shpjeguar sa më qartë pasojat dhe ndikimin e politikave dhe praktikave jodemokratike mbi çështje që kanë rëndësi për qytetarët.⁵¹ Për shembull, një çështje me rëndësi për prindërit mund të jetë ndikimi i dëmshëm i mediave komerciale në shoqërimin e fëmijëve, ndërsa një çështje shqetësuese për punonjësit e bibliotekave dhe arsimtarët mund të jetë liria e informimit dhe aksesit në informacion.

51 Historikisht, angazhimi i qytetarëve në aktivizmin mediatik ka qenë i kufizuar, përveç kohërave të trazirave dhe ndryshimeve shoqërore, për shkak të ngarkesës së jetës së përditshme dhe opinionit se çështjet e medias dhe komunikimit nuk kanë lidhje me shqetësimet dhe problemet e përditshme të qytetarëve.

Për të fituar një rezonancë kulturore dhe politike më të madhe, aktivizmi mediatik ka nevojë të tërheqë grupe të larmishme qytetare, si prindërit, bibliotekarët, të rinjtë, etj. Mobilizimi i ardhshëm i qytetarëve do të varet nga aftësia e aktivistëve mediatikë për të komunikuar pasojat e politikave dhe praktikave antidemokratike në çështjet që tashmë kanë rëndësi për qytetarët.

Iniciativat e advokimit në media shpesh hasin në rezistencë të fortë nga mediat kryesore që janë kapur nga interesa të korruptuara politike dhe ekonomike, si dhe nga ato organe mediatike që përfitojnë më shumë nga politikat dhe kulturat ekzistuese në media, dhe që pengojnë raportimin e drejtë të çështjeve dhe aktiviteve të advokimit mediatik. Gazetarët dhe sindikatat e tyre nuk kanë fuqi të mjaftueshme për të rezistuar dhe për t'iu kundërvënë interesave të punëdhënësve të tyre, pasi tregu është i vogël dhe nuk ka shumë mundësi për punësim alternativ. Një nga studimet e fundit të publikuara në internet nga Fushata për Lirinë e Shtypit dhe Transmetimit (Campaign for Press and Broadcasting Freedom), në vitin 2018, raportoi se organizimi kolektiv në sindikata edhe brenda një tregu të madh mediatik si ai në Mbretërinë e Bashkuar, ka ardhur duke u reduktuar. Sindikatat e lidhura me Fushatën kishin miliona anëtarë (deri në 4.4 milionë anëtarë, siç përmendet në faqen e internetit), por mbështetja e tyre ishte e kufizuar: "Ndërmarrja e fushatave nga jashtë dhe jo nga përbrenda sektorit së medias ka reduktuar aftësinë për të ushtruar presion të drejtpërdrejtë mbi punëdhënësit, dhe indirekt tek politikanët" (faqja e internetit të CPBF).

Disa nisma të aktivizmit mediatik kanë ecur mirë në rajon. Vetë fakti që ka iniciativa të vazhdueshme për futjen e edukimit mediatik në kurrikulat e sistemit arsimor në katër vende të rajonit (Serbi, Mali i Zi, Shqipëri, Maqedonia e Veriut) tregon se ka një sensibilizim në rritje të zyrtarëve qeveritarë dhe rritje të vullnetit politik për të trajtuar këtë çështje, ndaj dhe aktivistët e medias duhet që ta përdorin këtë moment pozitiv për të kërkuar ndryshime të mëtejshme.

Aktivitete dhe nisma të tjera ka më pak të ngjarë të gëzojnë po atë nivel mbështetje, pasi sfidojnë interesat mbizotëruese të sistemit (të zyrtarëve qeveritarë, reklamuesve kryesorë dhe mediave komerciale). Këto reforma mediatike do të varen nga ndryshimet në arenën politike që mund të vijnë si rezultat i dinamikave dhe ekuilibrave partiako-politike, por edhe nga ndikimi i lëvizjeve dhe iniciativave shoqërore që mbase nuk kanë lidhje direkte me median.

Reagimi i aktivizmit mediatik ndaj praktikave dhe nismave politike shqetësuese që janë vënë re në të gjithë rajonin është i rëndësishëm edhe për parandalimin e rënies së mëtejshme të integritetit të medias dhe sektorit të komunikimit. Ku të jetë e mundur, aktivistët e medias duhet të ngrenë zërin dhe të kërkojnë sistematikisht përmirësime thelbësore të politikave dhe praktikave të medias. Kjo mund të përfshijë pjesëmarrjen në grupe pune për hartimin e ligjeve dhe angazhimin në procese të tjera institucionale në lidhje me median dhe komunikimin. Për shembull, Free Press ofron rregullisht konsulencë për zhvillimin e politikave mediatike në SHBA.

Për sa i përket shtrirjes dhe kapaciteteve, pushteti i platformave të komunikimit që mbështesin interesat e qeverive dhe korporatave është shumë i madh. Siç thotë edhe Bob Hackett: "Reforma në media vështirë se mund të arrihet

Aktivizmi mediatik është një mjet i rëndësishëm për parandalimin e dobësimit të mëtejshëm të integritetit të mediave dhe komunikimit. Brenda mundësive, aktivistët mediatikë duhet të përcaktojnë agjendën dhe të advokojnë sistematikisht për përmirësime të ndjeshme të politikave dhe praktikave mediatike.

pa një lëvizje popullore të përkushtuar mbi këtë objekt. Vetëm një presion i vazhdueshëm popullor ka të ngjarë që të bindë qeveritë të sfidojnë dhe të zemërojnë konglomeratet mediatike” (2016).

Strategjitë e suksesshme për reforma në media zakonisht hartohen nga koalicionet e mëdha dhe të mirëorganizuara (ndërkoalicionet), për të rritur në maksimum ndikimin dhe efektshmërinë e aksionit politik. Lidhja dhe bashkërendimi i aksioneve dhe aktiviteteve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare mundëson shkëmbimin e njohurive dhe burimeve, ndërsa presioni i “bazës” ndaj klasës politike ka gjithashtu të ngjarë të amplifikojë shtrirjen dhe ndikimin e lëvizjeve për ndryshim. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe koordinimi i aktivistëve të medias ka rëndësi thelbësore sepse shumë nga temat që trajtohen nga aktivizmi mediatik janë probleme globale që përfshijnë çështje të lidhura me tregtinë dhe biznesin, politika rregullatore ekonomike, si dhe aktivitetin e gjigantëve të teknologjisë dhe platformave të transmetimit. Po kështu, në rastet kur kemi të bëjmë me përmbajtje mediatike veçanërisht të dëmshme, koordinimi i aktivistëve nga vende me tradita dhe gjuhë të ngjashme mund të ushtrojë më shumë ndikim dhe të ketë më shumë sukses në luftën ndaj dezinformimit, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit.

Shembujt dhe praktikët e mira të aktivizmit mediatik janë burim frymëzimi për të tjera iniciativa në të ardhmen, dhe larmishmëria e tyre përforcon bindjen se aktivizmi mediatik mund dhe duhet të marrë formë të ndryshme dhe të trajtojë një sërë çështjesh për të arritur në realizimin e reformave thelbësore. E ardhmja e medias është një çështje me rëndësi shumë të madhe politike, ndaj aktivistët e medias duhet të mundohen që të rrisin nivelin e mobilizimit të publikut të gjerë në mbrojtje të interesit publik në sektorin e medias dhe komunikimit. Edukimi mbi median dhe informimin duhet të bëhet pjesë e të gjitha strategjive të mobilizimit qytetar, si instrument për rritjen e interesit të qytetarëve mbi sektorin mediatik, si dhe për përvetësimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për një mobilizim sa më të efektshëm.

Strategjitë e suksesshme për reformat mediatike janë bërë nëpërmjet koalicioneve të gjera dhe të menduara mirë, me qëllimin për të rritur ndikimin dhe për të mundësuar efikasitetin politik.

E ardhmja e mediave është një çështje kyçe politike dhe aktivistët mediatikë duhet të ndërtojnë një shumëllojshmëri përpjekjesh dhe modelesh të mobilizimit të një qytetarie më të gjerë në mbrojtje të interesit publik në sektorin e medias dhe komunikimit.

LITERATURA DHE BURIMET

Baumgarth, C., Kirkby, A., Lambrecht A. (2021). Fundi i reputacionit të keq të AI: Inteligjenca artificiale dhe menaxhimi i markës. (*End of the AI Brand Winter: Artificial Intelligence in Brand Management*) Fakulteti i Ekonomisë dhe Drejtësisë në Berlin

Carroll, W.K., Hackett, R.A. Aktivizmi demokratik në media nga këndvështrimi i teorisë së lëvizjes shoqërore. Media, kultura dhe shoqëria (*Democratic Media Activism Through the Lense of Social Movement Theory. Media, Culture and Society*), (2006), 28(1), 83-104.

Carpentier, N. (2011). Media dhe pjesëmarrja: Një arenë lufte ideologjiko-demokratike (*Media and participation: A site of ideological-democratic struggle*). Intellect: Bristol.

Custódio, L. 2017. Aktivizmi mediatik në zonat informale, favela: lëvizja publike për të drejtat e njeriut në Brazil. (*Favela media activism: counterpublics for human rights in Brazil*). Lexington Books, Lanham.

Dagron, A.G., 2001. Trazimi i ujërave: Histori të komunikimit me pjesëmarrje të gjerë për ndryshime shoqërore (*Making Waves: Stories of participatory communication for social change*). Fondacioni Rockefeller.

Dekić, S. 2013. Raport situatë Bosnjë Hercegovinë. Observatori i medias të Evropës juglindore (*Flash report Bosnia and Herzegovina. SEE Media observatory*) <https://mediaobservatory.net/radar/flash-report-2-bosnia-and-herzegovina>

Duncan, K. (Ed.) 1999. Alternativa çliruese: Konventa themeluese e Lëvizjes Mjedisore Kulturore (*Liberating alternatives: The founding convention of the Cultural Environment Movement*) Cresskill, NJ: Hampton Press.

Fahey, P. M. (1991). Bojkotimi nga grupe advokimi të kompanive që vendosin reklama në rrjetet kryesore televizive dhe ndikimi në programacion (*Advocacy group boycotting of network television advertisers and its effects on programming content*) Buletini juridik i Universitetit të Pensilvanisë, 140, 647-709. https://scholarship.law.upenn.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3685&context=penn_law_review [faqe e vizituar më 16 prill 2023]

Hackett, R. A. 2016. Të shpëtojme median: shënime mbi potencialin për lëvizje demokratike në komunikimin. Aleanca Mediatike (*Taking back the media: notes on the potential for a communicative democracy movement. Media Alliance*) Mund të vizitohet tek: <https://media-alliance.org/2016/05/taking-back-the-media-notes-on-the-potential-for-a-communicative-democracy-movement-by-bob-Hackett/> [faqe e vizituar më 16 prill 2023]

Hackett, R. A. & Carroll, W. K. 2006. Reformimi i medias: Lufta për të demokratizuar komunikimin publik (*Remaking media: The struggle to democratize public communication*). Nju Jork: Routledge.

Hackett, R. A. & Carroll, W. K. (2004). Lëvizjet shoqërore kritike dhe reforma në media [nga Zhvillimet në Media, 4(1), 14-19] (*Critical social movements and media reform* (in Media Development, 4(1), 14-19), varianti që mund të përdoret lirshëm nga publiku mund të lexohet tek <http://www.sfu.ca/~Hackett/CriticalSocialMovements.htm>.

Hadl, G. dhe Dongwon, J. 2008. Përçasje të reja ndaj mediave tona: Sfidat e përgjithshme dhe rasti korean (*New approaches to our media: General Challenges and the Korean case*). Tek: Pajnik, M. dhe Downing, J. (eds). Media Alternative dhe Politika e Rezistencës (*Alternative Media and the Politics of Resistance*). Lubljana: Instituti i paqes, p.81-109.

Hodzic, S dhe Petkovic, B. 2020. Qëndrueshmëria e gazetarisë së pavarur në mjedisin e biznesit mediatik të Ballkanit perëndimor (*Sustainability of Independent Journalism in Media Business Environment of Western Balkans*). TACSO.

Hoey, P. 2018) Trimat e Sinn Fein, rivalët dhe disidentët: Aktivizmi i medias republikane në Irlandën e Veriut që nga marrëveshja e së Premtes së Mirë (*Shinners, Dissos dhe Dissenters: Irish Republican Media Activism Since the Good Friday Agreement*). Shtëpia botuese e Universitetit të Mançesterit.

Horwitz, R. B. 1997. Analizë e reformës në radio-televizion: pastori Everett C. Parker dhe çështja e "Palës paditëse" (*Broadcast reform revisited: Reverend Everett C. Parker and the "Standing" case*) Buletini i Komunikimit (Communications Review 2(3):311– 348)

Jakubowicz, K. 1990. Solidarnost dhe reforma mediatike në Poloni. Botuar nga Buletini Evropian i Komunikimit ("*Solidarity' and Media Reform in Poland*". *European Journal of Communication*), 5(23), 333–354.

Klinenberg, E. 2007. Lufta për valët: Beteja për të kontrolluar mediat e Amerikës (*Fighting for Air: The Battle to Control Americas Media*), Holt Paperbaks.

Kranich, N. 2004. Media, demokracia dhe bibliotekat: Forcimi i aktivizmit mediatik në Shtetet e Bashkuara (*Media, Democracy and Libraries: The Growth of Media Activism in the United States*). Feliciter, 50(5), fq. 200-203.

McChesney, R.W. Të njohim lëvizjen për reforma në media. Botuar nga Buletini Ndërkombëtar i Komunikimit (*Understanding the Media Reform Movement. International Journal of Communication*) 3 (2009). <https://ijoc.org/index.php/ijoc/article/download/442/299>.

McChesney, R.W, Lëvizja mediatike në SHBA: Marshojmë përpara. Botuar nga Buletini Mujor (*The U.S. Media Movement: Going Forward. Monthly review*), 2008, Vol. 60 (04). <https://monthlyreview.org/2008/09/01/the-u-s-media-reform-movement-going-forward/>

Menezes Teixeira, A. C. E. 2020. Aktivizmi mediatik në bazë dhe narrativa antihegemoniste e politikës (*Grassroots media activism and the counter-hegemonic narrative of politics*), *Ephemera* 20 (1), 147–175.

Mueller, M, Kuerbis, B., Pagé, Ch. (2004). Rishpikja e aktivizmit mediatik: Advokimi i interesit publik në hartimin e politikave të komunikimit dhe informimit në SHBA, Botuar nga Politika Informacioni (*Reinventing Media Activism: Public Interest Advocacy in the Making of U.S. Communication. Information Policy*), 1960-2002

Mueler, M, Pagé, Ch. Kuerbis, B. 2004. Shoqëria civile dhe formëzimi i politikës së komunikim-informacionit: Katër dekada advokim. Botuar nga Shoqëria e Informacionit (*Civil Society and the Shaping of Communication–Information Policy: Four Decades of Advocacy*). The Information Society, 20, 160-185.

Napoli, Philip M., 2007. Aktivizmi dhe advokimi i medias me interes publik si lëvizje sociale: Një analiza e literaturës. Publikuar nga Qendra McGannon, Seria e punëve kërkimore (*Public Interest Media Activism and Advocacy as a Social Movement: A Review of the Literature*. McGannon Center Working Paper Series. 21) https://fordham.bepress.com/mcgannon_working_papers/21.

Pajnik, M. dhe Downing J.D.H. 2008. Media alternative dhe politika e rezistencës: Këndvështrime dhe sfida. Revista Ephemera: Teoria dhe politika në organizim (*Alternative Media and the Politics of Resistance: Perspectives and Challenges*. Ephemera: Theory and Politics in Organisation)

Renzi, A. 2011. Nga kooperativat tek kooperimi: aktivizmi mediatik italian dhe përdorimi inovativ i mediave sociale (*From Collectives to Connectives: Italian Media Activism and the Repurposing of the Social*), Universiteti i Torontos, Toronto, <https://hdl.handle.net/1807/29845>, <http://bnarchives.yorku.ca/635/>.

Simon, J. 2023. Një paradigmë e re për gazetarinë globale: liria e shtypit dhe interesi publik (*A New Paradigm for Global Journalism: Press Freedom and Public Interest*). Mund të lexohet tek: https://www.cjr.org/tow_center_reports/a-new-paradigm-for-global-journalism-press-freedom-and-public-interest.php#The%20Platforms%20and%20Public%20Interest

Schiffrin, A. ed, Kapja e mediave: Si i kontrollon lajmet para, platformat digjitale dhe qeveria (*Media Capture: How Money, Digital Platforms, and Governments Control the News*). Nju Jork: Shtëpia e botimit të Universitetit Columbia, 2021.

Young-han Kim, Lëvizja e audiencës të radio-televizionit në Kore ("*The Broadcasting Audience Movement in Korea*") (2001). *Media, Kultura dhe Shoqëria*. 23(1). 91–107.

Wible, Scott (2004). Aktivistët e medias, qytetarët e Amerikës latine dhe televizionet kabllore tematike. Kufijtë e televizionit 'pa kufi' (*Media advocates, Latino citizens and niche cable. The limits of 'no limits' TV*) *Studime Kulturore (Cultural Studies)* 18:1, 34-66.

Të gjitha faqet janë vizituar gjatë periudhës prill - tetor 2023.

MBI AUTORIN

Sanela Hodžić ka një diplomë master në Studime Gjinore nga Qendra e Studimeve Ndërdisciplinore, Universiteti i Sarajevës. Ajo është studiuese e pavarur, por më parë ka punuar për një kohë të gjatë si eksperte e punës kërkimore dhe koordinatore e studimeve në Qendrën e Medias Sarajevë.

MOBILIZIMI NË MBROJTJE TË INTERESIT PUBLIK NË MEDIA

Shembuj të metodave dhe praktikave më të mira të aktivizmit mediatik

Ky botim është pjesë e komponentit kërkimor të projektit **“Media jonë: Një projekt i shoqërisë civile për të nxitur edukimin për median dhe aktivizmin, kundër polarizimit, në dobi të dialogut.”** Seria e dytë e raporteve studimore u krye si pjesë e kuadrit tematik të titulluar “Identifikimi i praktikave të mira të aktivizmit mediatik në vende të ndryshme të botës, duke përfshirë vendet përfituese të projektit- Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi.”

Projekti **“Media jonë: Një projekt i shoqërisë civile për të nxitur edukimin për median dhe aktivizmin, kundër polarizimit, në dobi të dialogut”** zbatohet nga nëntë organizata për zhvillimin e medias nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia, me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Koordinator i këtij projekti tre-vjeçar është Fondacioni Mediacentar Sarajevë. Partnerët e projektit janë Instituti Shqiptar i Medias në Tiranë, BIANET në Stamboll, Instituti Maqedonas i Medias në Shkup, Instituti i Medias i Malit të Zi në Podgoricë, Shkolla e Gazetarisë të Novi Sad, Instituti i Paqes në Lubjanë; Këshilli i Shtypit të Kosovës në Prishtinë dhe Rrjeti i Evropës Juglindore për Profesionalizimin e Medias (SEENPM).



South East European Network
for Professionalization of Media